# GAZETA SHQIPTARE

KORÇA BEER
edhe sot me e mira ...

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7800 E premte 22 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

KORÇA BEER
edhe sot me e mira ...

Opinioni i Ditës

Nga ANDI BUSHATI



## Donika Prela, një arsye më shumë pse duhen djegur mandatet

Në kulmin e debateve për djegien e mandateve të opozitës, një ngjarje në dukje krejt periferike, kaloi pa vëmendjen e duhur të publikut. Prokurorja e komanduar ... Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga KIM MEHMETI



## Edi Ramës duhet me ligj t'i ndalohet të merret me politikë!

Shqiptarinë e kanë ngulfatur politikanët si kryeministri aktual i Shqipërisë, të cilët posa bëhen burrështetas, e humbin pushtetin mbi vetveten! Dhe si ... Vijon në faqen 21



Mijëra në shesh, karafila në parlament

# Opozita dorëzon mandatet, Basha: Protesta në të gjithë Shqipërinë

Kryemadhi: Deputetët “rebelë”, në kazanin e plehrave. Garda i heq Berishës shoqëruesit

Nga VALENTINA MADANI

Opozitarët dje e nisën protestën me karafila dhe e mbyllën me Himnin Kombëtar. Të rinjtë e Forumit Rinor të PD-së në nisje të protestës hodhën karafila para godinës së parlamentit e rrethuar prej kordonit të policisë si paralajmërim ...

Në faqet 2-3

MINISTRIA E FINANCAVE PUBLIKON DOSJET E SHQYRTUARA NE JANAR-TETOR 2018

# TE PERNDJEKURIT, 5 MIJE EMRAT QE MARRIN PARATE

Të dhënat e detajuara për çdo trashëgimtar, çfarë dokumentesh duhet të dorëzojë secili prej tyre. Përfituesit e këstit të tretë, nevojitet llogari bankare aktive




*(Në foto)* Ish-të përndjekur në protestë

Në faqet 11-13

ZBARDHEN TELEFONATAT

## SHBA e BE, thirrje opozitës: Jo djegies së mandateve, dënoni dhunën në protesta

Në faqen 4

INTERVISTA NE “NEWS 24”

## Ish-senatori i SHBA: Irani tentoi sulme terroriste në Paris dhe Shqipëri

Në faqen 10

FLET AKADEMIKU

## Rexhep Qosja: 4 delegacione të Kosovës në bisedime me Serbinë, komedi

Në faqen 18

SHENDETESIA

## Infermierët, akuza portalit të punësimit: Nuk ka transparencë, ja dyshimet tona

Në faqet 8-9

FORMULARI



## ATP nis pagesën për kompensimin për 750 pronarë në të gjithë vendin

Në faqen 7

Kryeministri: S’mund të bëjmë asgjë për vetëvrasjen politike të opozitës

# Rama: Dialog, por s’ka zgjedhje të parakohshme

*“Për parlamentin votohet në vitin 2021”. Klosi: Zgjedhje lokale pa PD-LSI*

Kryeministri Edi Rama nuk tërhiqet. Ai do të vijojë të jetë kryeministër i vendit dhe zgjedhje të parakohshme parlamentare nuk do të ketë. Në një fjalim të gjatë prej afro 35 minutash, kreu i qeverisë ndonëse i ka shtrirë dorën e bashkëpunimit opozitës, nuk ka bërë



asnjë hap pas në drejtim të përmbushjes së kërkesave të saj, duke theksuar se zgjedhjet lokale do mbahen në 30 qershor dhe ato parlamentare në qershor të vitit 2021. “Kjo është zgjedhja më e keqe që ka bërë opozita sot. Nuk mund të bëjmë ...

Në faqen 5

PROTESTA
OPOZITA

### Zbardhen emrat e deputetëve të opozitës që nuk dorëzuan mandatin e deputetit

# Basha sot në Vjenë, opozita dorëzon mandatet: Rama ik!

## Refuzimi, flasin Mediu, Ndoka, Murrizi dhe Hajdari

Valentina Madani

Nga 21 shkurt 2019, deputetët e opozitës nuk do të jenë më në parlament. Nën thirrjen "Rama ik" dhe të shoqëruar nga mijëra mbështetës, kryetari i PD-së, Lulzim Basha; kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi dhe deputetët e grupeve parlamentare të opozitës dorëzuan zyrtarisht mandatet në kryesinë e Kuvendit. Opozita kërkon largimin e kryeministrit Edi Rama dhe krijimin e një qeverie kalimtare, që do të organizojë zgjedhje të parakohshme. Në orën 12:30, Lulzim Basha dorëzoi në kryesinë e Kuvendit listën me mandatet e deputetëve të Partisë Demokratike. Basha shoqërohej nga sekretari i përgjithshëm i partisë që ai drejton, Gazmedn Bardhi. Pas Bashës, mandatet e deputetëve i dorëzoi edhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi. Më pas, opozita dhe turma e madhe e protestuesve iu drejtuan selisë së Partisë Demokratike, ku Lulzim Basha mbajti një fjalim përmbyllës. Pas dorëzimit të mandateve në kryesinë e Kuvendit, kreu demokrat, Lulzim Basha deklaroi nga selia e PD-së se opozita i vuri kryqin parlamentit. "Opozita parlamentare sot dorëzoi mandatet dhe i vuri kryqin parlamentit. Ne jemi qytetarë të thjeshtë në krahun tuaj, me ju dhe për ju, nisëm sot një rrugëtim shprese, i cili nuk do të ndalet derisa festimi i këtij vendi të bëhet realitet, derisa ta largojmë kryehajdutin dhe qeverinë e tij kriminale. Le ta shpërndajmë këtë energji hyjnore që buron nga shpirti i një race siç jemi ne. Le të nisim këtë udhëtim shprese, për të rikthyer besim dhe bindjen se e nesërmja po vjen. Banda e tij solli këtë të zezë, Shqipëria do të ketë një të ardhme dhe kjo do të jetë e juaja, e fëmijëve tuaj, e njerëzve të ndershme. Do t'i japim fund padrejtësisë. Do të kemi një qeveri të popullit, për popullin. Derën e Europës do e hapim. Shqipëria do të ketë një të ardhme, ky është mesazhi im për të gjithë ju", u shpreh z.Basha. Në përmbyllje të protestës së opozitës, kreu i opozitës këndoi Himnin Kombëtar përpara protestuesve të shumtë që ishin mbledhur përpara selisë së PD-së.

**REFUZIMI**

Deputetët e opozitës dje dorëzuan zyrtarisht mandatet parlamentare, ndërsa vijuan me protestën dhe me kërkesën për zgjedhje të parakohshme dhe një qeveri transitore. Por, jo të gjithë deputetët e opozitës e dorëzuan mandatin. Nga PD janë Fatmir Mediu, Nard Ndoka, Myslym Murrizi dhe Rudina Hajdari dhe nga LSI-ja, Lefter Koka. Mësohet se Fatmir Media dhe Nard Ndoka ndodhen aktualisht jashtë vendit, në Vjenë e për këtë arsye nuk e kanë firmosur ende lënien e mandatit. Z.Basha sot do të shkojë në Vjenë, pasi do të zhvillojë një takim me asamblenë parlamentare të OSBE-së dhe më pas do të kthehen bashkë me Mediun dhe Ndokën. Kreu i PR-së, Fatmir Mediu, sqaroi dje se ndodhet në Vjenë dhe sapo të kthehet në Tiranë, do të firmosë dokumentin njësoj si deputetët e tjerë të opozitës. "Unë kam dy ditë në Vjenë. Kjo është qesharake. Unë kam bërë një deklaratë si deputetët e tjerë të opozitës. Mandati im është të mandati i qytetarëve demokratë. Nuk është vënë ndonjëherë në diskutim ajo çka kërkojnë dhe vendosin qytetarët. Unë nuk kam mandat. Në momentin e parë që do të jem në Tiranë, do të kryej të gjitha aktet formale për ta bërë. E kam bërë deklaratë publike dhe do e formalizoj. Nuk kam mundësi ligjërisht nuk do të ishte e qëndrueshme. Jam këtu për të përfaqësuar zërin e opozitës dhe të qytetarëve dhe sa të kthehem, do të bëj të njëjtin veprim si kolegët e mi. Vendimi im është i koordinuar me z.Basha", theksoi z.Mediu. Edhe kreu i PDK-së, Nard Ndoka, sqaroi të vërtetën në lidhje me dorëzimin e mandatit, duke thënë se ndodhet në Bruksel. Ai siguroi se sapo të kthehet, do t'i bashkohet vullnetit të gjithë opozitarëve të tjerë që i dorëzuan mandatet e deputetit. "Ndodhem në Bruksel. Sapo të kthehem, do ta firmos dorëzimin e mandatit", - tha z. Ndoka. Përmes një postimi në "Facebook", edhe deputetja Rudina Hajdari shprehet se ndodhet në SHBA, ku ka zhvilluar takime me disa zyrtarë atje dhe mendohet se kjo është arsyeja e mos firmosjes së lënies së mandatit. "Diskutime të dobishme në Këshillin e BE-së për hapat e mëtejshme të Shqipërisë në rrugën për hapjen e negociatave të Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Dje pata takime me personalitete evropiane përgjegjës për njësinë e zgjerimit, në fokus të të cilave ishte "qëndrimi që pritet të mbajë Këshilli i BE-së në qershor", - shprehet Hajdari. Kurse deputeti demokrat, Myslim Murrizi është një nga pesë opozitarët që nuk e ka djegur ende mandatin e deputetit. Ai tha se është kundër djegies së mandatit. "Kam qenë konstant kundër djegies së mandateve, sepse ne ato i kishim të djegura. Pse na futën në dhjetor? Kam qenë konstant në grup parlamentar, edhe në mbledhje të tjera. Kam pyetur nëse janë konsultuar për një vendim të tillë me ndërkombëtarët dhe partitë motra europiane. Kam që nga viti 2009 që bërtas për ndryshimin e Kodit Zgjedhor, për sistemin maxhoritar dhe zgjedhje të drejta dhe jam i bindur se me sistemin maxhoritar askush prej butakëve në parlament nuk do të fitojë", - u shpreh Murrizi.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje pas dorëzimit të mandateve në Kryesinë e Kuvendit

**TAKIMI**

Lideri i opozitës, Lulzim Basha, pasi u kërkoi dje protestuesve që të mblidhen sërish në protesta të tjera që do të pasojnë ditët në vijim, mblodhi aleatët për të përcaktuar axhendën e re të opozitës kundër qeverisë. Basha paralajmëroi se shumë shpejt opozita do të nisë një tur takimesh dhe protestash në qytetet më të mëdha të vendit, në shenjë rezistence ndaj qeverisë "Rama".

## "Mandatet", Kryemadhi: Deputetët rebelë do të përfundojnë në kazanin e plehrave

Drejtuesja e LSI, Monika Kryemadhi, e cilësoi si një liri të zinxhirit politik nga krimi dorëzimin e mandateve nga ana e opozitës. Në një prononcim për mediat, pas takimit të mbajtur me kreun demokrat në selinë blu, Kryemadhi tha se opozita do e çojë deri në fund misionin e saj për rrëzimin e kryeministrit Rama nga qeveria. "Besoj se mesazhi është shumë i qartë. Sot na dhanë më shumë energji dhe pozitivitet për ta çuar deri në fund misionin dhe ndarjen përfundimtare me atë parlament, për të cilin për 27 vjet shqiptarët kanë shpresuar se jemi në demokraci, por që na ktheu mbrapsht. Sot opozita dhe deputetët e opozitës janë të lirë nga kapja e çdo zinxhiri politik, i cili është i lidhur me krimin më shumë se kurrë. Ajo çfarë ndjejnë deputetët, edhe unë vetë personalisht, është që më shumë seç kushton liria, nuk kushton asgjë tjetër. Dhe liria është një nga gjërat më të mira, sepse në fund të fundit morali dhe përfaqësimi që kemi ne nuk është që të përfaqësojmë grupet e interesit, oligarkët apo kapjen e individëve të caktuar. Qoftë kjo nga drejtësia, apo qoftë nga krimi i organizuar apo allishverishet e caktuara", deklaroi zj. Kryemadhi.



E pyetur nëse ka deputetë të tjerë nga radhët e LSI që nuk do të djegin mandatin përveç Lefter Kokës, Kryemadhi nuk i kurseu paralajmërimet në drejtim të këtyre të fundit. "Grupi teknik po punon, por këtu nuk është çështje deputeti, këtu është çështje fryme. Kush deputet do të përfundojë në kazan të plehrave si ato të Ukrainës, le ta provojë. LSI-në, opozitën nuk i mbajnë peng as inceneratorët, as tenderat, as vetingu dhe asgjë tjetër. Faleminderit".



Protesta e djeshme e opozitës

**DENONCIMI**

AKEP ndërpreu sinjalin e të gjithë operatorëve të telefonisë celulare në të gjithë bulevardin, përfshirë zonën e protestës dhe përreth Partisë Demokratike. PD tha se Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ka urdhëruar bllokimin në mënyrë paligjshme të valëve celulare në zonën ku po zhvillohej protesta si dhe në zonën rreth selisë së PD.

**GENT STRAZIMIRI**

"Në protestë ishte populli, jo një grup kriminal. Kur një qeveri ka dalë nga populli dhe rrethohet nga populli, do të thotë që ka ardhur momenti për t'u larguar. Diskutimi për lënien e mandateve është i përditshëm. Diskutimi në grup ka qenë se kur do jetë momenti i duhur. Unë mendoj që 16 shkurti doli përtej", - u shpreh z.Strazimiri.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafile VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



**DEKLARATA**

"Sot (dje) dorëzuam mandatet. Prej ditës së sotme jemi qytetarë të thjeshtë në krahun tuaj me ju e për ju. Nisëm një rrugëtim shprese, i cili nuk do të ndalet derisa destini europian i këtij vendi të bëhet realitet. Opozita i vuri kyçin parlamentit të krimit. Bëhuni gati për betejën e radhës në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Korçë, Elbasan, Durrës, Dibër, Tropojë e Sarandë anembanë vendit", - u shpreh z.Basha.



**Truprojat japin dorëheqjen dhe dorëzojnë armët**

## Berishës i heqin shoqëruesit: Gjest frikacakësh, ndjehem më i fortë se kurrë

Pas protestës së fundit të 16 shkurtit, ish-kryeministrit Sali Berisha i janë hequr bodiguardët, të cilët e shoqërojnë prej vitesh. Mësohet se shoqëruesve të Berishës u është komunikuar urdhri fill pas protestës që të rikthehen në detyrën në Gardën e Republikës, ku do të ushtronin shërbim në ruajtjen e institucioneve. Mësohet se bodigurardët e ish-kryeministrit kanë paraqitur dorëheqjen pas këtij urdhri dhe kanë dorëzuar armët e shërbimit. Ndërkohë që dje e shoqëruan privatisht, Sali Berishën në protestën para parlamentit. Berisha është paraqitur në protestë me shoqëruesit e zakonshëm, të cilët ndryshe nga herët e tjera në këtë protestë ata ishin të pa armatosur. Vetë Berisha në një prononcim për Ora News e cilësoi si akt frikacakes vendimin për t'i hequr shërbimin e ruajtjes fizike. "Ndihem më i fortë dhe më i motivuar se kurrë. Një gjest frikacak dhe hakmarrës i Edi Ramës, por unë jam mes qytetarëve më i fortë se kudo tjetër. Do të vazhdoj çdo minutë, çdo orë, çdo javë, çdo muaj betejën deri në çmontimin e narkoshtetit në Shqipëri derisa shqiptarët të votojnë të lirë siç u takojnë", deklaroi z.Berisha. Garda njoftoi mediat se "Kryeministri i vendit përfiton shërbim ruajtje për një periudhe 3-vjeçare pas përfundimit të detyrës, është ndërprerë vijimi i mëtejshëm i këtij shërbimi". "Në përgjigje të interesit të disa mediave, lidhur me truprojat e zotit Sali Berisha, Garda e Republikës informon se në zbatim të Nenit 5, të Ligjit Nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ku përcaktohet se kryeministri i vendit përfiton shërbim ruajtje për një periudhe 3-vjeçare pas përfundimit të detyrës, është ndërprerë vijimi i mëtejshëm i këtij shërbimi",-thuhet në reagimin e Gardës.

Mijëra në shesh, protesta nis me karafila para Kuvendit, mbyllet me Himnin Kombëtar

# Protesta në të gjithë Shqipërinë, Basha: Do udhëheqim një betejë civile

## *Kreu i PD mesazh ndërkombëtarëve: S'jemi populli i dhunës*

Valentina Madani

Opozitarët dje e nisën protestën me karafila dhe e mbyllën me Himnin Kombëtar. Të rinjtë e Forumit Rinor të PD-së në nisje të protestës hodhën karafila para godinës së parlamentit e rrethuar prej kordonit të policisë si paralajmërim se do të ishin paqësorë në demonstrimin e tyre kundër qeverisë. Ndërkohë që policia kishte rrethuar të gjithë perimetrin e parlamentit, disa protestues gjetën "rrugë zgjidhje", duke hipur në pemë. Çdo deputet mbajti një fjalim të shkurtër ku njoftonte se ka hequr dorë nga mandati dhe kërkoi rrëzimin e Ramës. E gjithë protesta u mbajt nën mbikëqyrje të rreptë nga policia ndërsa organizatorët për të mos lejuar incidentet vendosën të rinj ndërmjet protestuesve dhe forcave të rendit. Protesta e nisur rreth orës 10:30 fillimisht para parlamentit për t'u zhvendosur më pas para kryesisë përfundoi rreth orës 13:00 me fjalimin mbyllës të kryetarit të PD-së Lulzim Basha, i cili paralajmëroi se tani protestat do të jenë jo vetëm në Tiranë, por dhe në shumë qytete të tjera. Përpara mijëra qytetarëve, të cilët protestuan tek parlamentit, kreu i opozitës Lulzim Basha dha një mesazh për ndërkombëtarët. "Dua këtë mesazh të parë t'ia u them miqve tanë. Ne nuk jemi populli i dhunës, ne jemi populli i demokracisë, ne jemi populli i Shqipërisë, ne jemi e ardhmja europiane e vendit. Ne nuk do të pranojmë kurrë më një Kryeministër bandit", deklaroi z.Basha. Ai i garantoi ata se do jetë pranë tyre deri në largimin e Ramës. "Jam qytetar i Tiranës, në krahun tuaj dhe me ju. Zoti e ka nisur rrugëtimin dhe bashkimin e shqiptarëve pa ndërprerje deri në largimin e qeverisë së krimit. Rama ik! Ne kërkojmë atë që na takon. Sytë e Europës dhe partnerëve tonë strategjikë, BE, SHBA, janë nga sot tek ky shesh ne do tregojmë vlerat dhe parimet. Lulzim Basha do qëndrojë në krahun tuaj, sepse unë besoj tek demokracia, tek zgjedhjet e lira dhe të ndershme, tek qeveria e së drejtës. Unë besoj tek lira, mundësia për çdo shqiptar",- u shpreh Lulzim Basha.




Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje me protestuesit

## Shehi entuziazmon protestuesit: Në Kuvend kthehemi si burrat

Fjalimi i shkurtër i Dashamir Shehit u shoqërua me duartrokitje nga protestuesit përpara parlamentit. Shehi akuzoi kryeministrin Edi Rama si të keqen më të madhe që ka pasur Shqipëria në vitet e pas diktaturës. Ndërsa pranoi edhe gabimet e demokratëve kur kanë qenë në qeveri, Shehi u shpreh se është Edi Rama që po ndan shqiptarët. "Ky zotëria është e keqja më e madhe që na ka rënë 30 vjet. Nuk kemi qenë mrekullia as ne, po si ky nuk i kishte rënë Shqipërisë. Prandaj duhet ta përzemë. Ky njeri që bredh poshtë e përpjetë Shqipërisë duke hedhur helmin kundër shqiptarëve, që pretendon se do bashkojë Shqipërinë dhe Kosovën, ky do ta ndajë dhe Shqipërinë. Por nuk kemi për ta lënë, kjo është rrugë që mund të jetë e gjatë, nuk kemi rrugë tjetër. Kjo që po bëjmë bashkë bëhet për të mirën e Shqipërisë. Nuk na ka lënë shteg përveç protestës së rrugëve. Do të vijë dita që do t'i kthehemi asaj salle, por do t'i kthehemi si burrat. Keni ardhur nga gjithë Shqipëria",-deklaroi z.Shehi.



**THIRRJA**

Kreu i PD-së i bëri thirrje Policisë së Shtetit të mos lejojë daljen nga kufijtë e Shqipërisë të të pandehurit Edi Rama. "Ligji dhe Kushtetuta janë produkt i sovranit, zbatimi i tyre është produkt i shtetit. Dua t'ua them miqve të mi që për arsye të ndryshme akoma nuk e dinë se këtu akoma nuk ka demokraci dhe se shteti është kapur nga krimi i organizuar, se njeriu që ju del përpara si kryeministër është "Maduro i Ballkanit", por me një ndryshim. Kjo nuk është Venezuelë, kjo është Shqipëria në mes të Europës. Shqiptarët nuk do ta pranojnë kurrë, unë nuk do të pranoj kurrë që Kushtetuta të kthehet në letër higjienike nga një kriminel që përfaqëson llumin e shoqërisë. Nuk do të pranoj kurrë kapjen e pushteteve teksa pasurohen një grusht njerëzish. Unë nuk do të pranoj kurrë zgjedhjet e blera. Kurrë nuk do ta pranoj narkoshtetin. Ne jemi njerëzit e demokracisë, ne jemi njerëzit e vlerave",- theksoi z.Basha.

**FTESA**

Lideri i opozitës Lulzim Basha ftoi protestuesit e shumtë para parlamentit që ta ndiqnin deri tek Kryesia e Kuvendit, aty ku do të dorëzonin mandatet të gjithë deputetët e opozitës. Basha përmendi se shpresa e vetme është Europa dhe se dera e saj duhet të hapet me çdo kusht. "Mos i prekni vëllezërit dhe motrat tanë policë se janë të nënpaguar. Ky është vetëm fillimi. Ndaj le ta nisim bashkë sot këtë rrugëtim shprese drejt të ardhmes tonë europiane. Shpresa jonë është Europa. Dera e saj e mbyllur duhet të hapet me çdo kusht, të vetmit që mund ta hapim jemi ne, populli i Shqipërisë. Le ta nisim udhëtimin tonë tani. Ndiqmëni bashkë me të gjithë anëtarët deri tek kryesia e Kuvendit. Ejani të gjithë pas nesh për të dorëzuar mandatet për t'i dhënë fund këtij regjimi kriminal, për të marrë në dorë fatet tona si njerëz të lirisë. Të gjithë pas meje për të finalizuar këtë akt patriotik", u shpreh z.Basha. Po dje Kryetari PD-së, në një deklaratë për prestigjiozen "Associeted Press" pak para se të niste protesta, u shpreh se opozita e bashkuar do të udhëheqë një betejë civile, për të rivendosur, sipas tij, legjitimitetin dhe demokracinë në Shqipëri. "Opozita parlamentare ka vendosur unanimisht të djegë mandatet parlamentare dhe sot është dita që do të depozitojmë këtë akt të paprecedent me qëllim ndarjen nga një parlament që nuk është produkt i votës së popullit, por është produkt, siç është ekspozuar nga biseda të përgjuara të publikuara nga media ndërkombëtare, i krimit të organizuar në bashkëpunim të hapur me qeverinë aktuale. Ne tani do të udhëheqim një betejë civile, paqësore e demokratike për të rivendosur legjitimitetin dhe demokracinë në Shqipëri",- theksoi z.Basha.

KRIZA POLITIKE

QEVERIA

Zyrtari i DASH ka telefonuar krerët e opozitës: Mos dëmtoni proceset demokratike

# SHBA e BE, thirrje opozitës: Jo djegies së mandateve, dënoni dhunën

## Mogherini dhe Hahn: Po minoni progresin drejt BE

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian janë në të njëjtën linjë qëndrimi kur bëhet fjala për vendimin e opozitës për të djegur mandatet e deputetëve. SHBA dhe BE kanë dënuar dhunën dhe retorikën e ashpër politike, ndërsa janë shprehur kundër nismës për djegien e mandateve nga deputetët opozitar. Për SHBA ka reaguar DASH nëpërmjet Zv/ Ndihmës Sekretari i Shtetit për Evropën Matthew Palmer, i cili i ka përcjellë qëndrimin amerikan personalisht kreut të PD-së, Lulzim Basha dhe kryetares së LSI-së, Monika Kryemadhi në dy telefonata të ndryshme që ka pasur me ta mbrëmjen e mërkurës. Ndërkohë që për BE ka reaguar shefja e Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian Federica Mogherini dhe komisioneri Johannes Hahn nëpërmjet një deklarate të përbashkët.

**DASH**

VOA raportoi dje se Zv/ Ndihmës Sekretari i Shtetit për Evropën Matthew Palmer në bisedat telefonike që ka zhvilluar me Bashën dhe Kryemadhin i ka bërë thirrje atyre që të mos i dorëzojnë në masë mandatet dhe të dënojë publikisht dhunën e ushtruar gjatë protestave. Sipas zëdhënësit të Departamentit të Shtetit, zoti Palmer u bëri thirrje të dy udhëheqësve të opozitës të qëndrojnë të angazhuar në mënyrë konstruktive në proceset demokratike, duke theksuar rolin jetik, që partitë e opozitës duhet të luajnë në një shoqëri demokratike. Diplomati i lartë amerikan, siç u shpreh zëdhënësi për 'Zërin e Amerikës', "i këshilloi" dy kryetarët e partive "kundër dorëheqjeve të koordinuara dhe në masë të deputetëve të opozitës nga parlamenti, pasi kjo do të dëmtonte përpjekjet për reforma dhe do të dëmtonte një institucion të rëndësishëm të demokracisë". Gjithashtu, raportohet se Palmer, ndërsa theksoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për të drejtën e qytetarëve për të protestuar në paqe, u bëri thirrje, si Bashës, edhe Kryemadhit të hedhin poshtë dhe të dënojnë publikisht gjithë dhunën.

**BE**

Ndërkohë që pas deklaratave të veçanta të ekspozentëve kryesorë europianë, dje edhe Bashkimi Europian ka dalë me një deklaratë zyrtare ku ka shprehur mbështetjen për protestat, por duke deklaratë që nxit aktet e dhunës në protesta. "Ne riafirmojmë të drejtën e qytetarëve për t'u angazhuar në demonstrata paqësore si një tipar thelbësor dhe një vlerë thelbësore e demokracisë, por ne fuqimisht denoncojmë çdo retorikë nga udhëheqësit politikë që bëjnë thirrje për dhunë", - thuhet në deklaratën e përbashkët të Mogherinit dhe Hahn. Më tej dy përfaqësuesit e lartë të BE-së theksojnë se edhe vendimi për dorëzimin e mandateve dëmton demokracinë dhe procesin integrues të Shqipërisë. "Vendimi i opozitës për heqjen dorë nga mandatet e tyre pengon seriozisht funksionimin e demokracisë në Shqipëri. Parlamenti është vendi ku reformat dhe zhvillimet përkatëse duhet të diskutohen dhe të zhvillohen, e jo të bojkotohen. Këto vendime dhe akte janë kundërproduktive, shkojnë kundër zgjedhjes demokratike të shtetasve shqiptarë dhe minojnë progresin që vendi ka bërë në rrugën e Bashkimit Evropian", - thuhet në këtë deklaratë. Më tej Mogherini dhe Hahn shprehen se Bashkimi Evropian pret që të gjithë anëtarët e Parlamentit shqiptar të mbrojnë idealet dhe parimet e demokracisë, të vazhdojnë të shërbejnë në Kuvend dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të shmangur aktet e dhunshme dhe deklaratat nxitëse. "Ne po ashtu presim që qeveria dhe opozita të angazhohen në diskutime konstruktive me qëllim tejkalimin e situatës aktuale politike në të mirë të Shqipërisë dhe qytetarëve të saj", - mbyllet deklarata e BE.



Zv.ndihmës Sekretari i Shtetit për Evropën Matthew Palmer

**DASH**

Diplomati i lartë amerikan, siç u shpreh zëdhënësi për 'Zërin e Amerikës', "i këshilloi" dy kryetarët e partive "kundër dorëheqjeve të koordinuara dhe në masë të deputetëve të opozitës nga parlamenti, pasi kjo do të dëmtonte përpjekjet për reforma dhe do të dëmtonte një institucion të rëndësishëm të demokracisë".

## Lënia e mandateve, Fleckenstein: I zhgënjyer, prishje e kontratës

Raportuesi për Shqipërinë në Bashkimin Europian, Knut Fleckenstein ka reaguar sërisht ndaj situatës politike në të cilën ndodhet vendi ynë, duke theksuar se klasa politike shqiptare nuk duhet të presë gjithmonë që të vijnë negociator nga BE për të zgjidhur krizat politike. "Mos prisni që gjithmonë të vijnë arbitër nga Brukseli për të sheshuar çdo grindje" - tha raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Europian dhe eurodeputeti gjerman, Knut Fleckenstein në një intervistë për "Deutsche Welle". Fleckenstein nuk ka preferuar të flasë për akuzat e opozitës se qeveria është e lidhur me bandat. Ai tha se këtë duhet ta faktojë prokuroria dhe gjykata. Për sa i përket djegies së mandateve, raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Europian u shpreh se protestat nuk duhet të zëvendësojnë jetën parlamentare. "Kjo është një lloj prishjeje kontrate. Nuk mund të them, nëse kjo është e drejtë apo e gabuar, por di që parlamentarët duhet ta kryejnë punën e tyre në parlament. Jam i zhgënjyer që papushim na duhet të flasim për atë që deputetët t'i ushtrojnë apo jo mandatet e tyre. Por është e vështirë për mua të jap një përgjigje për atë, nëse opozita ia kthen vendet e deputetëve popullit apo nëse i ushtron detyrat e saj, këtë duhet ta vendosin vetë ata, nuk mund të jap një këshillë", - tha Fleckenstein.





Protesta e djeshme e opozitës

### Jagland: Parlamenti, shkalla e parë ku zgjidhen çështjet politike

Krahas Bashkimit Europian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, situata në Shqipëri ka shqetësuar edhe Këshillin e Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, Thorbjorn Jagland ndërsa ka komentuar vendimin e opozitës për djegien e mandateve të deputetëve të vet, ka theksuar se parlamenti është arena kryesor e debatit për çështjet politike. Ndaj ka theksuar ai opozita nuk duhet të çojë deri në fund nismën e saj për djegien e mandateve. "Në një demokraci legjislatura është shkalla e parë ku çështjet politike që prekin të gjithë vendin duhet të debatohen dhe duhen kërkuar zgjidhje. Opozita shqiptare nuk duhet të braktisë parlamentin" - tha Jagland. Duke u ndalur në protestën e opozitës së bashkuar në Tiranë, ai u shpreh se palët duhet të përmbahen nga retorika e dhunshme dhe dhuna në rrugë. "E drejta e tubimit dhe demonstrimit duhet të ushtrohet në mënyrë paqësore",- u shpreh Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

### Meta takon studiuesin Fischer: Mirënjohje për kontributin e tij

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ka zhvilluar dje një takim me studiuesin e njohur të historisë së Shqipërisë, amerikanin Bernd Fischer. Lajmin e bën të ditur vetë Kreu i Shtetit, i cili ka postuar edhe një foto nga ky takim. "Një takim i ngrohtë me studiuesin e njohur amerikan të historisë së Shqipërisë, Bernd Fischer, me të cilin pata kënaqësinë të bisedoja për sfidat që ka kaluar vendi ynë në periudha të ndryshme. Mirënjohje për kontributin e tij të vyer në ndriçimin e historisë sonë",-shkruan presidenti Meta. Bernd J. Fischer është profesor i Historisë së Ballkanit dhe drejtor i departamentit të historisë në Universitetin e Indiana - s, Fort Wayne. Është autor i një sërë librash rreth Shqipërisë, duke përfshirë "Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri", "Shqipëria gjatë luftës, 1939 - 1945" dhe "Identitete shqiptare, miti dhe historia".



## Klosi: Në zgjedhje lokale, edhe nëse PD dhe LSI s'marrin pjesë

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi është i bindur se pavarësisht nëse opozita merr pjesë ose jo, zgjedhjet vendore të 30 qershorit do të zhvillohen. Sipas tij opozita nuk është vetëm PD dhe LSI, por edhe çdo forcë tjetër që është e pakënaqur dhe në opozitë me qeverinë. "Padyshim që do të ketë zgjedhje lokale. Ç'është kjo s'ka opozitë? Ka opozitë sa të duash, ka njerëz të pakënaqur me punën tonë, pse duhet të luajë Pele në fushë që të quhet lojë futbolli? Pele ka ikur, sikurse edhe Ronaldo etj, kanë ardhur të tjerë të rinj. Edhe kjo punë kështu ka për të shkuar. Problemi më i madh nuk është kush i jep, por kush i merr, pasi do kërkojnë t'i marrin prapë ato mandate që lanë sot", - deklaroi Klosi. Ai theksoi se në historinë tonë 28-vjeçare të demokracisë në Shqipëri, kush ka bojkotuar dhe kush është tërhequr nga gara, e ka pasur jashtëzakonisht të vështirë të futet sërish në garë. "Ne jemi aty për të garuar dhe kemi detyrën kryesore të përfaqësojmë vullnetin e njerëzve që na mbështesin. Nëse ata mendojnë se vullnetin e mbështetësve të tyre e përfaqësojnë duke bojkotuar, atëherë është zgjedhja e tyre",-tha Klosi



## Balla: Askush s'ka të drejtë të dëmtojë perspektivën tonë europiane

Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla e ka konsideruar të papranueshme tentativën për të marrë pushtetin me dhunë apo nëpërmjet presionit për dorëzimin e mandateve. Duke folur dje në një konferencë për mediat, Balla është shprehur lënia e mandateve nga opozita është një akt i pamenduar mirë prej tyre dhe që dëmton gjithë vendin. "Ndava me kolegët e parlamentit çek shqetësimin e thellë për hapin e pamenduar mirë të hedhur nga deputetët e opozitës, sepse si në çdo vend demokratik marrja e pushtetit me dhunë apo përpjekjet për delegjitimimin e proceseve demokratike është e papranueshme dhe e pa tolerueshme", - deklaroi Balla. Sipas numrit dy të socialistëve, me dorëzimin e mandateve opozita injoroi popullin. "Asnjë parti politike në Shqipëri nuk ka të drejtë të dëmtojë perspektivën europiane të Shqipërisë dhe se mandatet parlamentare përfaqësojnë vullnetin e popullit. Dorëzimi apo dorëheqja prej tyre është injorimi i vullnetit të popullit".

### Kreu i qeverisë ka theksuar se zgjedhjet parlamentare do mbahen në 2021

# Rama: Gati të dialogojmë me opozitën, por zgjedhje të parakohshme s'ka

## "S'mund të bëjmë asgjë për vetëvrasjen politike të opozitës"

Kryeministri Edi Rama nuk tërhiqet. Ai do të vijojë të jetë kryeministër i vendit dhe zgjedhje të parakohshme parlamentare nuk do të ketë. Në një fjalim të gjatë prej afro 35 minutash, kreu i qeverisë ndonëse i ka shtrirë dorën e bashkëpunimit opozitës, nuk ka bërë asnjë hap pas në drejtim të përmbushjes së kërkesave të saj, duke theksuar se zgjedhjet lokale do mbahen në 30 qershor dhe ato parlamentare në qershor të vitit 2021. "Kjo është zgjedhja më e keqe që ka bërë opozita sot. Nuk mund të bëjmë asgjë për vetëvrasjen politike të opozitës. Populli do të flasë në zgjedhjet e qershorit dhe ato të 2021. Përgjegjësia është të vijojmë drejt dhe t'u shërbejmë me përkushtim të gjithë shqiptarëve pa asnjë dallim, aq më tepër kur demokratët nuk i përfaqëson asnjë në Kuvend. Dora e bashkëpunimit me opozitën është e shtrirë edhe kjo temë do të ketë kohën e vet më herët se vonë", - tha kryeministri Edi Rama. Ai theksoi se ka mandat për të qeverisur vendin deri në 2021 dhe se askush nuk mund t'i imponohet vullnetit të popullit të shprehur me votë. Kreu i qeverisë u shpreh se nuk do të heqë dorë nga mandati që ka marrë nga shqiptarët duke i kujtuar opozitës se në 2017 u rikonfirmua, teksa në pushtet ishte bashkë me opozitën, e cila monitoroi zgjedhjet. "Jam zgjedhur kryeministër dy herë, herën e parë në një koalicion pas tetë vitesh në opozitë, herën e dytë me shumicë absolute pas një palë zgjedhjesh në një qeveri me opozitën, kujtoj që opozitës iu dhanë të gjitha ministritë që kërkonte dhe agjenci shtetërore, plus kryetarin e KQZ dhe gjithçka tjetër që kërkoi", - deklaroi kryeministri. Ndaj ai nënvizoi se nuk do të pranojë kurrë që të dialogojë për retorikën e dhunshme dhe as imponimin me dhunë të raporteve politike. "Opozita ka konsumuar një akt të panjohur në historinë e vendeve me zgjedhje. Një akt i paparë dhe i padëgjuar, por jo i pashpjegueshëm. Jemi gati të ulemi dhe të dialogojmë për gjithçka që i shërben forcimit të demokracisë. Një ndër gjërat që mund të diskutohet nuk është as retorika e dhunshme, as dhuna mbi institucionet dhe as imponimi me dhunë i raporteve politike dhe as ndërprerja e mandatit legjitim përmes një kamikazie politike", - u shpreh Rama. Ndërkohë që ai e konsideroi aktin e djegies së mandateve nga ana e opozitës si mjaft të rëndë dhe që sipas tij do ndikojë direkt te procesi i integrimit. "Kjo është ditë e keqe për demokracinë. E dëmshme sa të duash kjo sjelle destruktive e opozitës. Kjo është fatkeqësia e këtij vendi që goditet për të vetët. Mund të rezultojë fatale për çeljen e negociatave", - tha kryeministri, i cili theksoi se opozita ka frikë nga reforma në drejtësi dhe se nuk arrin dot të fitojë sërish zgjedhjet e 30 qershorit. Duke folur për një nga akuzat kryesore të opozitës, atë të shitblerjes së votave, kryeministri nuk e mohoi që ky fenomen ekziston, por duke theksuar se ata që e përfaqësojnë më mirë atë janë pikërisht aleatët e PD-së në opozitë, pra LSI. "Sa për blerjen e votave nuk e fsheh dot, që kur shoh Monikën që i thërret zotit që të mbrojnë Shqipërinë nga blerësit e votave them se i plotfuqishmi nuk merret me zgjedhjet, sepse po të ishte kështu, Monika sot do të ishte e para që do të shkonte në ferr për shitblerjen e votave", - tha ai. Duke konsideruar tashmë një fakt të kryer dorëzimin e mandateve nga opozita, Rama ka theksuar se detyra e qeverisë tashmë është që t'i bashkojë së më shumë shqiptarëve. "Jeta e tyre parlamentare mbaroi për këtë legjislaturë, por jeta e tyre politike vazhdon. Ne do shërbejmë me përulësi ndaj njerëzve të këtij vendi. Ata që ikën do bëjmë çmos të përçajnë më shumë, ne që jemi këtu do bëjmë të pamundurën të bashkojmë më shumë",- tha kryeministri.



Kryeministri Edi Rama

**VOTAT**

"Sa për blerjen e votave nuk e fsheh dot, që kur shoh Monikën që i thërret zotit që të mbrojnë Shqipërinë nga blerësit e votave, them se i plotfuqishmi nuk merret me zgjedhjet, sepse po të ishte kështu, Monika sot do të ishte e para që do të shkonte në ferr për shitblerjen e votave".

## Mandatet, Ruçi: Veprim i paprecedent, përgjegjësi e opozitës

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, priti dje në një takim delegacionin e Komisionit për Çështje Europiane të Dhomës së Deputetëve të Republikës Çeke, i cili po zhvillon një vizitë zyrtare në Shqipëri. Në takim ishte i pranishëm edhe Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla. Kryetari i Kuvendit informoi kolegët çekë edhe mbi zhvillimet e fundit politike në Shqipëri dhe vendimin e deputetëve të opozitës për "djegien" e mandateve parlamentare. "E përjetojmë me shqetësim këtë veprim të paprecedentë, sepse asnjëherë opozita nuk ka pasur në Kuvendin e Shqipërisë ato hapësira dhe ato instrumente që gëzon sot, si për procesin legjislativ, ashtu edhe për kontrollin parlamentar të qeverisë. Opozita është sovrane në vendimet e veta, të cilat ne nuk do t'i dëshironim kurrë, por për këto veprime përgjegjësia është tërësisht dhe vetëm e saj", - tha Ruçi. Kryetari i Komisionit për Çështje Europiane të Dhomës së Deputetëve të Republikës Çeke, Ondrej Benešík, u shpreh se qëndrimet e opozitës nuk janë pozitive për Shqipërinë. "Ne vlerësojmë se qëndrimet e opozitës shqiptare nuk janë pozitive për Shqipërinë. Opozita është në të drejtën e saj të kërkojë të ndryshojnë shumë gjëra, përfshirë edhe ndryshimin e qeverisë, por kjo duhet të arrihet duke përdorur instrumentet kushtetuese dhe demokratike. Dhe fusha e betejës së opozitës është vetëm në parlament", - tha ai.



**NJOFTIM ANKANDI**

**Përmbaruesi Gjyqësor Lekë Dodaj** shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të palës debitore, si më poshtë :

1. *Garazh* nr.68/55-G9, zona kadastrale 3292, volumi 25, faqe 39, *ndodhur në Seltë Tiranë në pronësi të* ***z.Besnik Abaz Hoshafi.***

**Çmimi me të cilën do të fillojë Ankandi i Parë është 5.681 *(pese mije e gjashteqind e tetedhjete e nje)* Euro.**

Ankandi zhvillohet në datën **05.03.2019, Ora 16.00** në zyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Lekë Dodaj në adresën *Rruga "Astrit Balluku", Ndërtesa 2, Hyrja 25, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

**Për kontakt: *067 39 00 666, dhe në adresë emaili leke_dodaj@hotmail.com.***

Taulant Balla: PD-LSI, sjellje tipike e një organizate terroriste

# Përfundon afati i aplikimeve për SPAK, kreu i KLP: Ja kriteret si do përzgjidhen 15 prokurorët

## "Në qershor, Shqipëria do të ketë prokuror të përgjithshëm me mandat kushtetues"



Deputeti i PS-së, Taulant Balla



**TIRANË**

Ditën e djeshme është mbyllur zyrtarisht afati që prokurorët të kandidojnë për të qenë pjesë e Prokurorisë Speciale, që pritet të hetojë rastet e korrupsionit të zyrtarëve të lartë. Në përfundim të afatit rezultojnë 27 prokurorë në garë për 15 vende në SPAK. Në një intervistë për gazetaren e Klodiana Lala, kreu i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Gent Ibrahimi tha se kandidimi i 27 prokurorëve është lajm i mirë, duke u nisur nga skepticizmi që kanë edhe për shkak të vetingut. "Është numër i mjaftueshëm për ne. E kuptoj hezitimin e prokurorëve, është bërë shkas edhe procesi i vetingut për një lloj skepticizmi të tillë. Fakti që kemi 27 kandidatë, është lajm i mirë. Na takon neve që të zgjedhim tani më të mirët mes tyre", u shpreh Ibrahimi. Për t'u përzgjedhur, Ibrahimi tha se ka kritere të shumta që nisin që nga aftësia për të hetuar me eficencë, për të qenë në gjendje të konfiskojnë pasurinë e krimit, për të treguar integritet etj.. I pyetur se si do të procedohet me kandidatët, pasi deri më tani vetëm 5 prej tyre e kanë kaluar vetingun, Ibrahimi sqaroi se: "Kjo çështje do gjejë rregullim sipas ligjit. Kemi të bëjmë me një ngritje në detyrë, ne do presim vetingun për të gjithë", - pohoi ai. Por, sa do të duhet të presim që të kemi një Prokurori Speciale funksionale? Ibrahimi nuk dha një datë të saktë, por sqaroi se duke parë volumin e dosjeve, do të marrë disa muaj kohë. "Duke pasur parasysh volumin e madh, 10 dosje për çdo kandidat, pra 270 dosje dhe faktin se nuk kemi mbështetje administrative dhe financiare, pra kjo do marrë kohë. Mund të marrim disa muaj në fund ne do ia dalim të bëjmë më të mirën", - vijoi ai. Gjithashtu, kreu i KLP-së pohoi se më 19 mars do të hapet gara për prokuror të përgjithshëm dhe se në qershor do bëhet zgjedhja e tij. Ndërkaq, kreu i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla ka përshëndetur përmbylljen e garës për SPAK.

**LISTA E APLIKIMEVE PËR SPAK**

**1.** Klodjan Braho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
**2.** Besnik Muci, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
**3.** Anton Martini, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
**4.** Edvin Kondili, prokuror pranë Prokurorisë për Krime të Rënda.
**5.** Ened Nakuci, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda
**6.** Eugen Beci, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda
**7.** Doloreza Musabelliu, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
**8.** Arben Kraja, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.
**9.** Vladimir Mara, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
**10.** Dritan Prenci, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
**11.** Shkelzen Cena, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, aktualisht i komanduar në Prokurorinë e Tiranës.
**12.** Behar Dibra, prokuror pranë Prokurorisë për Krime të Rënda.
**13.** Besim Hajdarmataj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda
**14.** Dorina Bejko, prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
**15.** Vate Staka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër
**16.** Fatmir Hoxhaj, drejtor në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Shtetërore, Ministrinë e Financave, 12 vite në sistemin e Prokurorisë.
**17.** Altin Dumani, prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë.
**18.** Enkeleda Osmani(Xhengo), prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
**19.** Elida Kackini (Selami), prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
**20.** Enkeleda Millonai, prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, aktualisht drejtuese e kësaj prokurorie.
**21.** Maksim Sota, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
2. Donika Prela, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Aktualisht drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
**23.** Elisabeta Imeraj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
**24.** Irena Nino (Vujoshi), anëtare e përkohshme pranë Komisionit të Monitorimit të Reformës në Drejtësi
**25.** Manjola Kajana, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda
**26.** Ndini Tavani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
**27.** Anita Jella, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

**POSTIMI I PLOTË I BALLËS**

Prokuroria Speciale Antikorrupsion (SPAK) në rrugë të mbarë, me një numër të konsiderueshëm kandidatësh (27) për të marrë këtë detyrë të rëndësishme. Politikanët e korruptuar nuk e ndalin dot më, edhe me përpjekjen e sotme. Nuk është rastësi që akti i sotëm antidemokratik i Sali Berishës, Lulzim Bashës dhe Monika Kryemadhit ndodhi pikërisht në ditën e përfundimit të aplikimeve për SPAK dhe në ditën që Kuvendi duhet të votonte strukturën e institucioneve kryesore të drejtësisë së re: Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Megjithatë, Kuvendi i shqiptarëve do ta votojë në seancën më të parë javën e ardhshme. Mandatet që PD dhe LSI paraqitën dorëheqjet nuk janë personale, as të partive respektive, por janë shprehje e vullnetit të popullit. Dorëzimi i dorëheqjeve prej shumë prej deputetëve të këtyre dy partive përbën një tradhti për të gjithë ata qindra mijëra qytetarë që besuan te platforma e opozitës në qershor 2017. Kjo sjellje e paprecedentë e PD dhe LSI sot ngjason gjithmonë e më shumë me një sjellje tipike të një organizate terroriste, e gatshme për të hedhur në erë të gjithë sistemin. Por, sistemi demokratik në Shqipëri është tashmë i konsoliduar, ndërsa institucionet shqiptare janë partnere të besueshme të SHBA dhe BE. Prej vitit 2013, Shqipëria ka përshpejtuar dhe thelluar ritmin e reformave, si dhe ka konsoliduar progresin në përmbushjen e pesë përparësive kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit, protestat e dhunshme dhe dorëzimi i mandateve nga ana e Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim vetëm pak muaj larg mbledhjes së Këshillit Europian në qershor 2019, minojnë qartësisht perspektivën europiane të Shqipërisë.

## SHKURT

### Përmetari i arrestuar Roland Milo pranon vrasjen e shokut

**TIRANË** - Roland Milo, i arrestuar dy ditë më parë në Vaqar të Tiranës, sipas burimeve për TV "Klan" ka pranuar në polici vrasjen e shokut të tij, Sokol Rama. Policia e kishte shpallur në kërkim, pasi dyshonte pikërisht se ishte autor i vrasjes së Sokol Ramës, bazuar edhe në provat e mbledhura në vendngjarje. Sokol Rama nga Tepelena u gjet i vrarë dy ditë më parë në malet e Këlcyrës. Ai ishte ekzekutuar dhe ishte hedhur në humnerë me makinë. Viktima ishte raportuar i zhdukur më 6 shkurt, pasi prindërit e tij kishin bërë denoncim në polici. Dyshohet se autori dhe viktima kishin trafikuar më parë një sasi kanabisi në Greqi dhe mendohet se mes tyre ka pasur konflikt.

### Falsifikonte dokumentet e pensioneve, prangoset postieri

**POGRADEC** - Një 40-vjeçar nga Pogradeci me detyrë postier pranë Postës Shqiptare në këtë qytet ka përfunduar dje në pranga, pasi akuzohet për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh. Sipas burimeve policore, shtetasi i arrestuar është Jetnor Shaho, i cili falsifikonte dokumentet e marrjes së pagesave për pensionistët, me qëllim përvetësimin e shumave monetare nga pensionet dhe shpërblimet e tyre. Mësohet se në lidhje me këtë rast, Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, ka kryer veprimet procedurale dhe ka referuar materialet pranë Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Pogradec, që prej datës 23.01.2019.

### Kapen 3 "skifterë" shqiptarë, akuzohen për 100 vjedhje

**ITALI** - Policia italiane ka arrestuar tre shqiptarë, të cilët akuzohen për mbi 100 raste vjedhjesh e grabitjesh, aktivitet ky i shtrirë në disa zona të shtetit fqinj e kryesisht në krahinat e Pordenone dhe Treviso. Sipas mediave italiane, të arrestuarit funksiononin si një bandë e strukturuar, e cila përmes këtij aktiviteti të paligjshëm përfitoi mbi 1 milion euro. Nga ky aksion u arrestuan tre të rinj të identifikuar si Darjel Prushi, i lindur në Krujë, Nikoll Dobrozi i lindur në Mamurras dhe Edmond Et'hemaj, i lindur në Peqin. Krahas vjedhjes së banesave e të shtëpive, grupi i shqiptarëve, i cili u shkatërrua gjatë ditës së djeshme, kryente edhe vjedhje argjendarish dhe prej aty mernin bizhu me vlerë të madhe.

Ndërtimet e paligjshme miratohet fondi, formulari për të marrë kompensimin

# ATP nis pagesën për kompensimin e 750 pronarëve në të gjithë vendin

## Fondi 552 milionë lekë, përfituesit në Tiranë, Elbasan etj.

Agjencia e Trajtimit të Pronave nis procedurat për kompensimin e 750 pronarëve që do të marrin kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi i vënë në dispozicion është rreth 552 milionë lekë. Bëhet fjalë për ndërtimet pa leje në drejtoritë për ALUIZNI-t, përkatësisht në Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Kavajë, Fshatra Turistikë dhe Kamzë, Vorë. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, vlera e kompensimit për 43 920,53 m2 është 522 842 426,65 lekë. ATP publikon edhe formularin që duhet të plotësojnë përfituesit për të marrë kompensimin. ATP sqaron se "subjektet përfituese, kërkesa e të cilëve nuk është pranuar për mungesë dokumentacioni gjatë procedurave të mëparshme, kanë të drejtë të riaplikojnë. Këto subjekte nuk paguajnë tarifë shërbimi, nëse provojnë pagimin e saj gjatë aplikimit të mëparshëm".

**APLIKIMI**

Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës kryen verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës, nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes. Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së, Tiranë, kërkesën-tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit, për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

**VENDIMI**

Në vendim përcaktohet se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI si rrjedhojë e kalimit të pronësisë ndërmjet shitjes së parcelës ndërtimore si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. Qeveria përcakton se për kompensim të pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë nëpërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen.


FORMULAR APLIKIMI
KOMPENSIM FINANCIAR PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE INFORMALE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:
Tel: (+355) 42 22 56 831 / 38
E-mail: info.atp@atp.gov.al
Web: www.atp.gov.al

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN
1. Emri
2. Mbiemri
3. Emri i Babait
4. NID
5. Gjinia Mashkull Femër
6. Datëlindja
7. Vendlindja
8. Shtetësia
9. Adresa
10. Qyteti
11. Rrethi
12. Kodi Postar
13. E-mail
14. Nr. Tel. Celular
15. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN
16. Subjekti përfitues
Emri / Mbiemri / Emri i Babait

Faksimile e formularit të aplikimit


Drejtoresha e ATP-së, Jonida Baçi

**PROCESI**

Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës kryen verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës, nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen.

### Paketa Fiskale për vitin 2019

## DRT: Mbi 4 mijë tatimpagues janë informuar mbi ndryshimet e reja



Informimit të tatimpaguesve në lidhje me ndryshimet ligjore të Paketës Fiskale të 2019 po i kushtohet një vëmendje e veçantë nga ana e Administratës Tatimore. Kjo është edhe arsyeja pse po realizohen vizita informuese nga ana e punonjësve të Shërbimit të Tatimpaguesve po realizohen vizita informuese në mjediset e ushtrimit të aktivitetit. Sipas të dhënave DRT njofton se deri tani janë informuar në terren mbi 4,000 tatimpagues. Punonjësit e Shërbimit të Tatimpaguesve në të 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore, përveç informimit mbi ndryshimet kryesore në legjislacionin tatimor po shpërndajnë edhe broshura e materiale informuese. Objektivi i Paketës Fiskale 2019 është përmirësimi i administrimit në mbledhjen e të ardhurave, reduktimin e kostove të përmbushjes tatimore, si nga biznesi, ashtu edhe nga administrata, por edhe nxitja e deklarimeve dhe pagesave në kohë. Paketa synon lehtësimin e procedurave tatimore, stimulimin e zhvillimit të sektorëve të bujqësisë, turizmit, energjetikës, inovacionit dhe të tjerë, reduktimin e evazionit fiskal dhe shmangies tatimore, si dhe lehtësimin e komunikimit kryesisht në rrugë elektronike, si me institucionet e linjës, ashtu edhe me tatimpaguesit. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i bën me dije tatimpaguesit që të marrin pjesë edhe në takimet e dedikuara informuese me ekspertët e saj, sipas kalendarit të përcaktuar për çdo drejtori rajonale tatimore.

**Shoqeria permbarimore JUSTITIA**

Shoqeria permbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e PARE , për shitjen e pasurisë së paluajtshme per te cilen ka vene hipoteke BKT BANK, me këto të dhëna:
Pasuria "ARE" nr. 17/5, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m² faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrrin Duurrës, në pronësi të z.Adrian Sefer Kapllani dtl.08.03.1969, zj.Merita Myzafer Kapllani dtl.24.06.1970 Në vlerën 11.600.000 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind mijë ) Lekë.
Pasuria Apartament me sip.120m2 nr.pas.41/150+1-1 zk.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh /13 Durrës në pronësi të z.Adrian Sefer Kapllani dtl.08.03.1969.
Në vlerën 5.381.856 (pese milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e teteqind e pesëdhjetë e gjashtë ) Lekë.

Ankandi zhvillohet në datën 07.03.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor me adrese Bulevardi"Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.



## Janar, 15 persona humbën jetën nga aksidentet rrugore, të cilat rriten në moshat e reja

Aksidentet rrugore vijojnë të jenë një ndër shkaktarët më të mëdhenj të vdekjeve në moshat e reja. Sipas INSTAT në muajin janar 2019, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 15 persona nga 13 që ishte një vit me parë. Gjatë janarit ndodhën gjithsej 104 aksidente rrugore nga 134 aksidente të ndodhur në janar 2018, duke ulur me 22,4 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Aksidentet rrugore, në 86,5 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup mosha 25 -35 vjeç duke zënë 28,8 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup moshë janë rritur me 30,4 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rrugët në Shqipëri vrasin më shumë se në çdo vend tjetër të Europës, së bashku me, Bosnjën dhe ish-shtetet e Bashkimit Sovjetik. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka publikuar të dhënat e reja lidhur me vdekjet në aksidentet rrugore për 100 mijë banorë. Me 13.7 vdekje për 100 mijë banorë, Shqipëria renditet ndër vendet me nivelin më të lartë të vdekjeve nga aksidentet në Europë.

# SHËNDETËSIA
## PROBLEMATIKAT

Kreu i Shoqatës së Infermierëve: Lista u ripublikua me pikë më të ulëta, dyshimet

# Infermierët, akuza mbi portalin e punësimit: Nuk ka transparencë

## Jaçaj: Mik i fortë, ose pagesa nën dorë për vendin e punës

Voltiza Duro

Infermierë për Shqipërinë" është një portal nëpërmjet të cilit, punonjësit e shëndetësisë si infermierë, fizioterapistë e teknikë imazherie apo laboratori mund të aplikojnë për një vend pune. Por menjëherë pas publikimit të pikëve të grumbulluara në testim, jo pak kandidatë kanë shfaqur shqetësimet e tyre e madje kanë theksuar se ky portal punësimi nuk është transparent. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, Elson Jaçaj tregon se gara e këtij viti u shoqërua me pakënaqësi nga ana e konkurrentëve. Publikimi i një liste, fshirja e saj dhe ripublikimi i një liste tjetër me pikë më të ulta për të testuarit ka sjellë revoltën e këtyre të fundit. Sipas Jaçaj asnjëherë nuk është bërë i njohur komisioni i vlerësimit e madje edhe pse testi është elektronik, përgjigjet nuk publikohen në moment. Ai shton se vendet vakante, nuk deklarohen aq sa janë në të vërtetë, por më pak, e kështu krijohen dyshime se punësimet bëhen me anë të ndonjë miku të fortë ose përmes sekserëve siç i konsiderojnë ata personat që i kontaktojnë pasi mbarojnë testimin e u thonë tarifat se sa duhet të paguajnë për një vend pune.


Kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, Elson Jaçaj

**Disa ditë më parë janë publikuar rezultatet e testimit të punonjësve të shëndetësisë që aplikuan nëpërmjet portalit "Infermierë për Shqipërinë". Të testuarit ngritën shqetësimin e publikimit dy herë të listës së pikëve. Sipas jush çfarë ka ndodhur?**

Po, në fakt, është e vërtetë që para pak ditësh u hap portali "Infermierë për Shqipërinë" për punësimin e infermierëve por si çdo herë i shoqëruar jo vetëm me pakënaqësi të konkurrentëve, por dhe me problematika të shumta. Kjo pasi nxjerrin një listë fituesish në adresën e portalit për konkurrentët pas disa orësh çuditërisht hiqet dhe nxjerrin një listë tjetër fituesish ku kishte shumë diferencë nga lista e parë. Kjo duke nisur që nga aplikantët që në listën e dytë shumica rezultonin me pikë të ulta se tek e para (ndërkohë që duhet të ishte e kundërta) pasi e para është vlerësimi i dosjes së aplikantëve dhe e dyta është vlerësimi i provimit, pra mbledhja e të dyjave duhet të nxirrte një listë me pikë më të larta e jo në fillim të larta e më pas iu ulen pikët. Dhe më e çuditshmja ishte që në listën e dytë që doli rezultonin aplikantë të rinj, pra që në listën e parë nuk figuronin e jo vetëm kaq, por rezultonin me pikë të larta pra fitues.

**BESUESHMERIA**

Jo vetëm në gjykimin tonë, por edhe numri më i madh i aplikantëve kanë shprehur pakënaqësi të mëdha për portalin e sidomos për këtë vit, sepse askush s'e di se kush dhe si vlerësohen dosjet e tyre që mund të kenë besueshmëri (pasi asnjëherë nuk iu është bërë i njohur komisioni i vlerësimit, nëse ka vërtet një komision).

**Sa transparent është ky portal punësimi dhe a bëhen vlerësimet në bazë të meritës?**

Jo vetëm në gjykimin tonë, por dhe numri më i madh i aplikantëve kanë shprehur pakënaqësi të mëdha për portalin e sidomos për këtë vit, sepse askush s'e di se kush dhe si vlerësohen dosjet e tyre që mund të kenë besueshmëri (pasi asnjëherë nuk iu është bërë i njohur komisioni i vlerësimit, nëse ka vërtet një komision). E dyta pakënaqësi është pasi shumica e pyetjeve janë të njohura nga aplikantët e për çudi rezultojnë me pikë të ulta pasi mbarojnë testimin (ku theksoj që edhe pse është testim elektronik, përgjigjet në vend që të dalin sapo mbaron testimi dalin shumë më vonë). Kjo ka ngritur shumë pikëpyetje tek të gjithë.

**A ka aplikantë që janë ende në listë pritjeje nga viti i kaluar?**

Ka akoma aplikantë nga portali i kaluar që janë fitues e janë në listë pritje e për çudi kur ata interesohen zbulojnë që ai vend vakant që ishte i lirë, është zënë nga dikush tjetër që s'dihet se kush është e se si ka hyrë aty.

**A kanë besim punonjësit e shëndetësisë te ky portal punësimi?**

Në fakt, ne e kemi thënë me kohë që portali thjesht është një orientim për infermierët e teknicienët e tjerë të dinë se ku ka vende të lira pune edhe pse kohët e

➔


Foto Illus

Rezultati i testimit për profilet Mami, Teknik laboratori, Teknik imazherie, Fizioterapist, Tiran Shkurt 2019

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 94 | Fizioterapi | Tirane | XHULIO ALEKSANDER RASPOPI | 51 |
| 95 | Fizioterapi | Tirane | XHULJA VALENTIN LULA | 37 |
| 96 | Fizioterapi | Tirane | XHULJAN FERIT KOLA | 49 |
| 97 | Mami | Berat | ANDIOLA ARBEN KUMARAKU | 35 |
| 98 | Mami | Berat | GERSJANA GEZIM PENXHO | 31 |
| 99 | Mami | Diber | ALFRIDA XHAFERR ISAKU | 48 |
| 100 | Mami | Durres | ABINA SKENDER DOKA | 29 |
| 101 | Mami | Durres | ANILA NDUE PRENGA | 40 |
| 102 | Mami | Durres | ARI THOMA SYLARI | 33 |
| 103 | Mami | Durres | ARJELA PELLUMB BLUSHI | 40 |
| 104 | Mami | Durres | AURORA KUJTIM VRAPI | 47 |
| 105 | Mami | Durres | AVIOLA VASIL PAPA | 39 |
| 106 | Mami | Durres | DESARA KUJTIM ZOGU | 37 |
| 107 | Mami | Durres | ELDA FATMIR DOKU | 33 |
| 108 | Mami | Durres | ESMA NDRICIM RAHI | 38 |
| 109 | Mami | Durres | ESMERALDA ELEZ DERVISHI | 35 |
| 110 | Mami | Durres | ESMERALDA GAZMEND SKONJA | 36 |
| 111 | Mami | Durres | FAZILE NDERIM ZAGRADI | 50 |
| 112 | Mami | Durres | FERDIJ TAHIR LELA | 39 |
| 113 | Mami | Durres | GRETA PANDELI PRIFTI | 45 |
| 114 | Mami | Durres | JONA TOMORR DRABO | 41 |
| 115 | Mami | Durres | JURGENA MITI LILA | 36 |
| 116 | Mami | Durres | LULJETA XHEMAL TROPLINI | 31 |
| 117 | Mami | Durres | MARSILDA MYQEREM BAXHIJA | 45 |

Faksimile e dy listave të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë për të njëjtin provim

Rezultati i testimit për profilet Mami, Teknik laboratori, Teknik imazherie, Fizioterapist, Tiranë 16 Shkurt 2019

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 94 | Fizioterapi | Tirane | XHULIO ALEKSANDER RASPOPI | 25 |
| 95 | Fizioterapi | Tirane | XHULJA VALENTIN LULA | 45 |
| 96 | Fizioterapi | Tirane | XHULJAN FERIT KOLA | 40 |
| 97 | Mami | Berat | ANDIOLA ARBEN KUMARAKU | 51 |
| 98 | Mami | Berat | GERSJANA GEZIM PENXHO | 49 |
| 99 | Mami | Diber | ALFRIDA XHAFERR ISAKU | 43 |
| 100 | Mami | Durres | ABINA SKENDER DOKA | 39 |
| 101 | Mami | Durres | ANILA NDUE PRENGA | 37 |
| 102 | Mami | Durres | ARI THOMA SYLARI | 40 |
| 103 | Mami | Durres | ARJELA PELLUMB BLUSHI | 46 |
| 104 | Mami | Durres | AURORA KUJTIM VRAPI | 47 |
| 105 | Mami | Durres | AVIOLA VASIL PAPA | 44 |
| 106 | Mami | Durres | DESARA KUJTIM ZOGU | 31 |
| 107 | Mami | Durres | ELDA FATMIR DOKU | 38 |
| 108 | Mami | Durres | ESMA NDRICIM RAHI | 42 |
| 109 | Mami | Durres | ESMERALDA ELEZ DERVISHI | 45 |
| 110 | Mami | Durres | ESMERALDA GAZMEND SKONIA | 41 |
| 111 | Mami | Durres | FAZILE NDERIM ZAGRADI | 39 |
| 112 | Mami | Durres | FERDIJ TAHIR LELA | 34 |
| 113 | Mami | Durres | GRETA PANDELI PRIFTI | 35 |
| 114 | Mami | Durres | JONA TOMORR DRABO | 39 |


**Shoqeria permbarimore JUSTITIA:**

**Shpall ankandin, faza I, për shitjen e pasurisë së paluajtshme per te cilat ka vene hipoteke NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:**

1. Pasuria me numër 5/1-B2, sip 115 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, K. Nëntokë, B2, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 454, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 25.600 (njëzet e pesëmijë e gjashtëqind ) Euro.

2. Pasuria me numër 5/1+1-28, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 28, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 448, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000(tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.

3. Pasuria me numër 5/1+1-47, sip 53.2 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 47, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 458, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 16,160 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë ) Euro.

4. Pasuria me numër 5/1-B1, sip 119.62m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, K. Nëntokë, B1, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 453, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 26.400 (njëzet e gjashtë mijë e katër qind) Euro.

5. Pasuria me numër 5/1+1-45, sip 27.01 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 45, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 456, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 8,240(tetë mijë e dyqind e dyzet) Euro.

6. Pasuria me numër 5/1+1-46, sip 26.45 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 46, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 457, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 8,080(tetë mijë e tetëdhjetë ) Euro.

7. Pasuria me numër 5/1+1-49, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 4, AP. 49, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 460, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 17.520 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet ) Euro.

8. Pasuria me numër 5/1+1-44, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 44, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 447, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000(tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.

9. Pasuria me numër 5/1+1-43, sip 67.73 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 43, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 446, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.

10. Pasuria me numër 5/1+1-25, sip 26.45 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 25, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 445, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 8,080(tetë mijë e tetëdhjetë ) Euro.

11. Pasuria me numër 5/1+1-26, sip 53.2 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 26, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 450, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 16,160 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë ) Euro.

12. Pasuria me numër 5/1+1-48, sip 70.38 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 48, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 459, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.

13. Pasuria me numër 5/1+1-24, sip 27.01 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 24, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 451, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 8,240(tetë mijë e dyqind e dyzet) Euro.

14. Pasuria me numër 5/1+1-23, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 23, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 452, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000(tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.

15. Pasuria me numër 5/1+1-22, sip 67.73 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 22, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 455, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 21,680 (njëzet e njëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë ) Euro.

16. Pasuria me numër 5/1+1-27, sip 70.38 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 27, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 449, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.

**Ankandi zhvillohet në datën 22.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor .Adresa: Bulevardi“Bajram Curri“, Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studio-justitia.com, tel. +355 4 2270890**



**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se më datë 15.03.2019 ora 8 °° - 16 °° ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i II-të për shitjen e 4 pasurive të paluajtshme , në pronësi të Shoqërisë “VICTORY INVEST” SH.P.K me vlera fillestare ne ankand: a)176,867.6 (Njëqind e shtatëdhjet e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjet e shtatë pikë gjashtë) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,795 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/66, Vol.18, Fq.152, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë “VICTORY INVEST” SH.P.K. ;b)171,172.4 (Njëqind e shtatëdhjet e një mijë e njëqind e shtatëdhjet e dy pikë katër) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,705 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/67, Vol.18, Fq.153, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë “VICTORY INVEST” SH.P.K.; c) 221,480 (Dyqind e njëzet e një mijë e katërqind e tetëdhjet) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 3,500 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/72, Vol.19, Fq.146, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë “VICTORY INVEST” SH.P.K.; d)94,920 (Nëntëdhjet e katër mijë e nëntëqind e njëzet) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 1,500 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/73, Vol.19, Fq.147, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë “VICTORY INVEST” SH.P.K. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



## "Kërkojmë rishikimin e tezave që të bindemi"

# Infermierët: Portali është një gënjeshtër e madhe, nuk na vlerësojnë sa meritojmë

Gazeta Shqiptare' ka kontaktuar ditën e djeshme me disa prej punonjësve të shëndetësisë që kanë aplikuar për vend pune në portalin "Infermierë për Shqipërinë". Ata e kanë cilësuar si një gënjeshtër të madhe këtë portal pasi sipas tyre, punësimi mund të arrihet vetëm me mik, para ose parti politike. "S'e kuptoj si ararini t'i besoni këto gënjeshtra, në punë futen ata që kanë lekun, mikun dhe më e rëndësishme partia! Është me mik pjesa e portalit, por ka dhe nga ata që kanë patur fat e kanë fituar. Edhe un kam një shoqe që ka filluar punë me portal, por e padrejtë është pjesa e pikëve ku s'na vlerësojnë për aq sa meritojmë në testim",-thotë infermierja me inicialet T. T për 'GSH'. Ata më tej theksojnë se ankesat e tyre nuk janë marrë për bazë nga institucionet përgjegjëse. "Janë bërë shumë padrejtësi. Në vlerësimin si të dosjes si të provimit dhe asnjë ankesë nuk është marrë për bazë. Kanë qenë pyetje të thjeshta të profesionit pasi kam 8 vite pune si dhe master shkencor, por dosja më është vlerësuar me 6.3 pikë",-thotë një tjetër infermier me inicialet G.GJ për 'GSH'.



**ANKIMIMI**

Pavarësisht kërkesave të tyre për rishikim teze, mesa duket deri më tani ankesat e punonjësve të shëndetësisë kanë rënë në vesh të shurdhët. "Unë jam penalizuar në portalin e parë. Nuk fillova punë me 50 pikë. Edhe tani në portalin që dhashë provimin në 10 shkurt 2019 nuk mora vlerësimin e duhur. Kërkoj rishikim të testit që të bindem!", - thotë infermierja O.T për 'GSH'./vo.du.

## Universiteti i Mjekësisë: Konkursi fillon në 5 mars për intervistat me gojë

Voltiza Duro

# Specializimet në Mjekësi, kur publikohen listat e konkurrentëve

## Udhëzimi/ Kalendari i zhvillimit të testit të informatizuar

Të gjithë ata që kanë aplikuar për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë në kryeqytet, brenda 28 shkurtit të këtij viti mund të njihen me listat e kandidatëve që janë pranuar për konkurrim. Sipas udhëzimit nr.2 firmosur nga rektori i universitetit, Arben Gjata, brenda dy ditësh, kandidatët mund të verifikojnë listën dhe në rast pakënaqësish mund të drejtojnë një kërkesë me shkrim pranë dekanatit të fakultetit përkatës. "Dekanatet brenda datës 28.02.2019 shpallin në faqen zyrtare ueb të fakulteteve dhe/ose UMT-së, listën emërore të kandidatëve të regjistruar për konkurrim, të cilët plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit. Kandidatët brenda dy ditëve nga shpallja verifikojnë listën emërore dhe në rast pasaktësish, bëjnë kërkesë për saktësim pranë dekanatit të fakultetit përkatës brenda datës 02.03.2019", - thuhet në udhëzimin e UM.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 169/33 Prot. Tiranë, më 19.02.2019

UDHËZIM
Nr. 2, datë 19.02.2019

PËR
DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 29.01.2019 "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019"

Në mbështetje të neneve 18, 70, 71, 77 dhe 89 të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit nr. 3, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2018-2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", dhe VKM-së nr.1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017, sot Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA),

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin nr 1, datë 29.01.2019 "Për procedurat e pranimit ... specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e M... 2018-2019" bëhen këto ndryshime:
1. Pika 6 bëhet si më poshtë:

Udhëzimi i Universitetit të Mjekësisë

**VERIFIKIMET**

Ndërkohë, brenda 4 marsit të këtij viti, dekanatet pas kryerjes së verifikimeve do të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve si dhe kalendarin e zhvillimit të intervistave me gojë dhe testimit të informatizuar. "Datat e zhvillimit të testimit të informatizuar konsultohen me QSHA lidhur me disponibilitetin për zhvillimin e testit. Listat e studentëve të ndara sipas datave të zhvillimit të intervistës me gojë dhe në vijim të testimit të informatizuar përcaktohen me short. Listat përfundimtare dhe kalendari i zhvillimit të testimit të informatizuar dërgohen në QSHA dhe MASR brenda kësaj date sipas formatit të kërkuar nga QSHA", - nënvizohet në udhëzim. Në këtë të fundit theksohet se kandidatët fillimisht do të kryejnë intervistën me gojë e më pas edhe testimin e informatizuar. Në udhëzimin që mban firmën e rektorit, Arben Gjata bëhet me dije më tej se konkurrimi do të fillojë në 5 mars të këtij viti për intervistat me gojë. "Rezultatet e intervistës me gojë shpallen nga komisioni pas aprovimit nga Dekanët. Dekanët shpallin rezultatet përfundimtare të intervistës me gojë në faqen ueb të fakulteteve përkatëse dhe UMT-së, si dhe në ambientet e fakulteteve dhe rektoratit brenda dy ditëve pune nga përfundimi i intervistës me gojë", - thuhet në udhëzim.

**REZULTATET**

"Rezultatet e intervistës me gojë shpallen nga komisioni pas aprovimit nga dekanët. Dekanët shpallin rezultatet përfundimtare të intervistës me gojë në faqen ueb të fakulteteve përkatëse dhe UMT-së, si dhe në ambientet e fakulteteve dhe rektoratit brenda dy ditëve pune nga përfundimi i intervistës me gojë", - thuhet në udhëzim.

fundit kemi vënë re që as vendet vakante, nuk deklarohen aq sa janë në të vërtetë, por më pak. Pra, që këtu ngrihet dyshimi (ose punësojnë në mënyra të tjera ashtu si dhe shumë aplikantë kanë deklaruar që, nëse kanë ndonjë mik të fortë ose përmes sekserëve siç i konsiderojnë ata personat që i kontaktojnë pasi mbarojnë testimin e u thonë tarifat se sa duhet të paguajnë për një vend pune). Ka raste kur vendet vakante lihen bosh me tendencë për ta rihapur disa herë portalin për të bërë show (gjasme sikur po punësojnë shumë veta).

**Një tjetër shqetësim i ngritur nga punonjësit e shëndetësisë është dhe fakti që pas aplikimit janë punësuar larg vendbanimit të tyre. A i shtyn kjo drejt largimit jashtë Shqipërisë?**

Shumica e aplikantëve për të mos thënë të gjithë s'kanë më besim tek portali për punësim, por thonë ta provojmë se s'kemi ç'farë humbim, fundja sa kohë të jemi në Shqipëri të shpresojmë mos shijojmë pak punë sa të mbarojmë kurset e gjuhës e të ikim jashtë. Nuk e mohojmë që ka pasur dhe nga ata që janë punësuar përmes portalit por me një ndryshim: asnjë nuk është futur aty ku ka fituar siç pretendohet nëpër show-n e punësimit, por janë punësuar ku i caktojnë e sigurisht nga nevoja që kanë për pune normalisht që do të pranojnë. Ka pasur dhe nga ata që janë punësuar shumë larg vendbanimit të tyre e kjo ka sjellë pakënaqësi pasi mendojnë për sa kohë janë në Tiranë me banim dhe i caktojnë të punojnë në Vorë, Durrës ose Kavajë pse nuk marrin bonus, ashtu si mjekët, por i lënë po me atë rrogë ku vetëm shpenzime transporti harxhojnë gjysmën e rrogës. Pra, kaq të nëpërkëmbur e të pavlerësuar janë infermierët në Shqipëri dhe pse bëjnë rreth 80% të punës në shëndetësi dhe janë pikërisht këta që sot po e mbajnë shëndetësinë në këmbë pasi shumë shpejt me largimet masive që po bëhen e me të drejtë, do jetë shumë vështirë një shërbim i mirë pas disa kohësh në vend.

**Pas gjithë këtyre shqetësimeve të ngritura pranë shoqatës, ju a i jeni drejtuar institancave përgjegjëse?**

Arsyeja pse na kontaktojnë ne si shoqatë është fakti që na kanë cilësuar si zëri i vetëm i tyre që po i përfaqësojmë e po ju qëndrojmë pranë jo vetëm për rritjen profesionale, por dhe për çdo problematikë që kanë. Infermierët dhe jo vetëm, e kanë parë që në pak kohë kemi arritur të sjellim shumë ndryshime tek infermierët duku iu zgjidhur problemet e tyre. Ndërsa u shkruajmë institucioneve të tjera përgjegjëse, asnjë nuk na është përgjigjur asnjëherë; përkundrazi ka pasur një reagim shumë të ulët nga ata që e kanë për detyrë jo vetëm ti sqarojnë, por dhe ti orientojnë se si duhet të veprojnë për çdo gjë. Shpesh ne kemi rrezikuar shumë si Shoqatë, duke u parë me sy negativ nga ministria apo dhe të tjerë për faktin që ngremë zërin e në shumë raste pse zgjidhim problemet e infermierëve, por fundja ky është qëllimi ynë pse jemi krijuar. Ka dhe sindikata të shëndetësisë apo dhe konfederata që pa pëlqimin e vetë infermierëve i kanë cilësuar këta të fundit si anëtarë të institucioneve të tyre, por vetëm sa për t'u marrë lekë pasi asnjëherë nuk kanë reaguar për asnjë problem që kanë pasur e jo më të kenë zgjidhur gjë. Pra, sot ata thonë që çdo institucion ku drejtohen e ka derën e mbyllur, e kjo ka bërë që shumë prej tyre të humbasin shpresën për punësim në Shqipëri duke parë për t'u larguar diku jashtë. Kur i trajtojnë kështu infermierët e nuk u japin as mundësi punësimi për kë po bëhen investimet në shëndetësi, godinat, aparaturat etj. kur të gjithë i kanë sytë drejt Gjermanisë dhe Europës për të punuar e spitalet dita-ditës po boshatisen e braktisen nga infermierët???

'Diplomaticus'/ Ish-senatori amerikan analizon arritjet e konferencës së Varshavës

# Robert Torricelli: Irani tentoi sulme në Paris dhe në Shqipëri

## *"Dëbimi i diplomatëve, vendim i mrekullueshëm"*

Erion Kaçorri


Ish-senatori amerikan, Robert Torricelli

Më 13 dhe 14 shkurt, në kryeqytetin e Polonisë, Varshavë, u mbajt konferenca e organizuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku në fokus ishte situata në Lindjen e Mesme, ndonëse të gjithë vëmendjen e mori çështja e Iranit dhe ndikimin destruktiv që sipas Uashingtonit, Teherani ka te vendet fqinje. Shtetet e Bashkuara u përfaqësuan në konferencë nga nënpresidenti amerikan, Mike Pence dhe sekretari amerikan i shtetit, Mike Pompeo. I pranishëm në konferencë ishte edhe kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, por aty u vu re mungesa e përfaqësuesve të lartë të Bashkimit Europian, siç është shefja e diplomacisë Europiane Federica Mogherini. Për të analizuar arritjet e kësaj konference, në emisionin "Diplomaticus" të gazetarit Erion Kaçorri ishte i ftuar ish-senatori amerikan, Robert Torricelli, i cili ishte pjesë e delegacionit amerikan. "Kërkesa kryesore e qeverisë time ishte që Irani t'i japë fund eksportit të terrorizmit, duke përmendur aktivitetet e Hezbollahut në Siri dhe vitin e kaluar kemi parë përpjekjet e Iranit për akte terroriste në Paris dhe këtu në Shqipëri. Këto nuk janë akte të rastësishme. Këto janë vepra të organizuara nga qeveria e atij vendi dhe qeveria e Francës, Belgjikës, Gjermanisë dhe tani qeveria e Shqipërisë kanë treguar kurajë të konsiderueshme dhe secila prej tyre duhet admiruar".

Duke komentuar kërkesën e nënpresidentit amerikan, Mike Pence, i cili nxiti Bashkimin Europian që t'i japë fund marrëveshjes bërthamore me Iranin, ish- senatori demokrat thekson se ka pasur një përpjekje fatkeqe nga disa vende të Bashkimit Europian për të ngritur një mekanizëm tregtar që do të shmangte sanksionet amerikane, por deri tani asnjë kompani e vetme, asnjë vend i vetëm, nuk ka arritur që të bëjë biznes përmes tij. "Mund të bësh biznes me Iranin, një vend i falimentuar me borxhe masive dhe një ekonomi të lëkundur, ose mund të bësh biznes me Shtetet e Bashkuara, një vend me një ekonomi prej 20 trilion dollarësh, me ekonominë më të madhe në botë. Cila kompani me mendjen në vend do të zgjidhte Iranin"?

Duke iu përgjigjur interesit të gazetarit në lidhje me mospjesëmarrjen në konferencën e Varshavës të përfaqësues së lartë të Bashkimit Europian për punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë Federica Mogherini, zoti Torricelli shprehet se kjo nuk është hera e parë që Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian kanë opinione të ndryshme. "Kjo ka ndodhur në luftën e Vietnamit, në luftën e fundit të Gjirit Persik. Gjithashtu, kemi pasur opinione të ndryshme për luftën në Afganistan. padyshim që kemi pasur qëndrime të ndryshme për luftën e ftohtë me ish-Bashkimin Sovjetik dhe kjo është pjesë e demokracisë. Edhe pse Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria janë aleate të ngushta, kjo nuk do të thotë se do të biem dakord mbi gjithçka. Ne nuk biem dakord mbi gjithçka me Britanikët", shprehet Torricelli për "News 24". Sipas ish- senatorit amerikan, një alternativë për Iranin është Këshilli Kombëtar i Rezistencës. "Ajo përfaqëson mijëra iraniane të diasporës që janë të aftë për drejtimin e Iranit. Që përfaqëson mijëra të rinj që protestojnë në rrugët e Iranit, që përfaqëson komunitetin e biznesit, njerëz të diasporës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Europë dhe këtu në Shqipëri. Këta janë njerëz të talentuar që mund të qeverisin vendin në sistem demokratik, jo në një diktaturë teologjike. Torricelli e quan lajm të mirë vendimin e Shqipërisë për të dëbuar diplomatët iranianë.

"Unë në fakt mendoj se është një zhvillim i mrekullueshëm. Shqipëria është pjesë e aleancës perëndimore ushtarake, është pjesë e bllokut politik të kombeve perëndimore. Nëse nuk dëboni një diplomat i cili po planifikonte një sulm terrorist në kryeqytetin tuaj, atëherë kur do ta dëboni atë shtron pyetjen ish-senatori amerikan Robert Torricelli për televizionin "News 24".


FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

**SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE**
**REQUEST FOR BIDS**

**Employer:** Albanian Development Fund (ADF)
**Project:** Community Works IV: Development of the Albanian Alps and Coastal Areas
**Contract title:** "Urban requalification and construction of the tourism centers in Vermosh"
**Country:** Albania
**Loan No.:** ALB - LD 1853
**RFB No:** CWPIV/W/OP/2018/17
**Issued on:** February 21, 2019

1. The Government of Albania has received a loan from the Council of Europe Development Bank (CEB) of 28,700,000 EURO toward the cost of the "Community Works IV: Development of the Albanian Alps and Coastal Areas" Project, and it intends to apply a portion of the proceeds of this loan to eligible payments for goods, works, related services and consulting services to be procured under this project. This project will be jointly financed with Government of Albania with a contribution of 6,000,000 EURO.
**Albanian Development Fund (ADF)** is the Project Implementing Agency for the "Community Works IV: Development of the Albanian Alps and Coastal Areas" Project.

2. ADF now invites sealed bids from eligible Bidders for the following contract to be funded from part of the proceeds of the loan:
**CWPIV/W/OP/2018/17, "Urban requalification and construction of the tourism centers in Vermosh"**.
The construction period is 10 months. The works are required having in consideration that in order to create a centrality it is needed to have an urban structure that defines building activities with their related public space.
There will be two levels of interventions: on the buildings scale and on public open air space within the landscape. Building A: Tourism Service Centre: TIC Shop for souvenirs and local agricultural product, offices for technical assistance, guest rooms / rural accommodation, restaurant / bar. Building B: – Guest rooms / Rural accommodation Small facilities as meeting rooms, bar restaurant and spa. Key Info Point C - Key attraction point along the walking path that brings to the open air museum - Shows the historical information about the ruins converted into museum. Museum D- Ruins of ancient school of Vermosh is turned into an open air museum. New parking area: roads are used only for local's accessibility -Bridge rehabilitation intervention.
The works consist in requalification of Vermosh Center: River protection, decorative stone plates covering, urban elements and landscaping; replacing the roof improving technology: ventilated roof system with waterproof membranes, insulation, finished with wooden pine plates fixed with metal profile, cleaning the finishes, removing mortar, refill with new injection to protect and reinforce the stone; consolidating the structure from inside: wall, floor, roof and staircase etc.
The Site is located at Malesia e Madhe municipality.
Some qualification requirements for this tender are as follows:
a) The Bidder must demonstrate access to, or availability of, financial resources such as liquid assets, unencumbered real assets, lines of credit, and other financial means, other than any contractual advance payments to meet the cash-flow requirement in an amount of 40,708,000 Albanian Leke, taking into account the Bidder's commitments for other contracts.
b) The Bidders shall have a minimum average annual turnover of: 325,665,000 Albanian Leke, calculated as total certified payments received for contracts in progress or completed, within the last 5 years (years 2014-2018).
c) The Bidder shall demonstrate that it has successful experience as prime contractor, in at least 3 (three) contracts within the last 5 years (years 2014-2018), each with a value of at least 108,500,000 Albanian Leke, that have been successfully completed and that are similar to the proposed Works.
A more detailed and complete list of evaluation and qualification criteria, for the tender is included in the respective bidding documents.
If ADF launches other tenders along with this tender, which will be evaluated in parallel, a Bidder that wishes to bid for more than one Contract, in this or other parallel tenders, in order to be awarded more than one Contract, he should meet the aggregate of the capacity requirements for each works contract that the Bidder wishes to be awarded for.
If the Bidder cannot meet the qualification criteria combined for more than one contract and he submitted the lowest evaluated responsive tender in those tenders, then ADF will award only those contracts that he meets the qualification criteria, provided that the combination of award will result in the lowest evaluated cost to the ADF for those contracts.

3. Bidding will be conducted through open tender procedures based on the CEB's Guidelines for Procurement of Supplies, Works and Services, September 2011 and is open to Bidders from any country, in accordance with the provisions on eligibility in the CEB's Guidelines for Procurement of Supplies, Works and Services, September 2011.

4. Interested eligible Bidders may obtain further information and inspect the bidding document during office hours 09:00 to 14:00 at the address given below.

5. The bidding document in English may be purchased by interested eligible Bidders upon the submission of a written application to the address below and upon payment of a nonrefundable fee of 100 Euro or equivalent in a convertible currency. The method of payment will be direct deposit to the ADF account, at Union Bank, as follows:
Name of the Bank: UNION BANK –Tirana, Albania
Name of account: "Llogari Projekti ADF"
IBAN CODE: AL47 2141 1106 0117 2854 6403 0120
Client number: 285464
For the direct deposit, the Bidder should provide Bank' payment receipt to ADF. Upon receipt of appropriate evidence of payment of the non-refundable fee, the documents will promptly be dispatched. In addition, if requested, the documents can be dispatched electronically after presentation by the prospective tenderer of an appropriate evidence of payment of the non-refundable fee. In the event of discrepancy between electronic and hard copies of the documents, the hard copy shall prevail.

6. Bids must be delivered to the address below on or before **March 27, 2019, 11:00 hrs**. Electronic bidding will not be permitted. Late Bids will be rejected. The outer Bid envelopes marked "ORIGINAL BID", and the inner envelopes marked "TECHNICAL PART" will be publicly opened in the presence of the Bidders' designated representatives and anyone who chooses to attend, at the address below directly after the deadline for submission of the bids. All envelopes marked "FINANCIAL PART" shall remain unopened and will be held in safe custody of the Employer until the second public Bid opening.

7. All Bids must be accompanied by a bid security in the amount of 2,713,800 Albanian Leke, or its equivalent in a convertible currency (using the Bank of Albania official exchange rate on the date of publication of the Specific Procurement Notice.

8. The addresses referred to above are:
For further information and inspection of the bid document:
Albanian Development Fund
Address: Rr. "Sami Frasheri", Nr. 10, Tirana, Albania
Contact name: Ms. Manjola Dhamo

Second Floor
Tel: +355 4 22 35 597/8
Fax: +355 4 22 34 885
E-mail: adf@albaniandf.org; mdhamo@albaniandf.org
Web site: www.albaniandf.org

For Bid submission:
Albanian Development Fund
Street Address: Rr. Sami Frasheri, No. 10
Floor/Room number: Ground Floor, Protocol Office
City: Tirana
Country: Albania

For Bid opening:
Albanian Development Fund
Street Address: Rr. Sami Frasheri, No. 10
Floor/Room number: Fourth Floor.
City: Tirana
Country: Albania

Ministria e Financave publikon listën me dosjet që ka shryrtuar nga janari deri në tetor 2018

# Ish-të përndjekurit, 5 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

## *Dokumentet që duhet të plotësojë çdo përfitues*

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e këstit të tretë duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Financave. Janë në total 5 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Pagesave nga janari deri në tetor të vitit të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar shënohet me "V" në rastet kur dokumenti është në rregull, me X kur është gabim dhe është kolona bosh kur dokumenti nuk është paraqitur.

**DOKUMENTET**

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një germë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq është i domosdoshëm një vendim fakti gjykate që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative e lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.

| EMER | MBIEMER | EMER | MBIEMER | KOPJE TE LETER NJOFTIM | NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE | CERTIFI-KATE VDEKJE | CERTIFI-KATE E TRUNGUT FAMILJAR | DESHMI I TRASHGI-MIE | PRO-KURE | CERTIFIKATE PER CDO NDRYSHIM IDENTITETI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | V | V | V | | |
| BEQIR | OMARI | | | V | X | | | | | |
| XHEMIL | OMARI | | | V | V | | | | | |
| | | | | | | V | V | V | | |
| Lejla | Frasheri | Nargis | Lungu | | | V | ret nga in | V | | |
| | | Tarik | Shkreli | V | V | | | | | |
| | | Vildan | Shkreli | V | V | | | | | |
| | | | | V | V | | | | | |
| Mehmet | Frasheri | Hajri | Frasheri | | | V | ret nga in | V | | |
| | | Hysref | Frasheri | V | | | | | P | |
| | | | | V | V | | | | V | |
| Nahide | Shkodra (Frasheri) | | | V | V | | | | | |
| Neriman | Frasheri | Ilona | Ziso | | | V | ret nga in | V | | |
| | | | | X | V | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | V | V | V | | |
| MYRVET | KRYEZIU | | | | | V | V | X | | |
| | | | | | | | | | | |
| MASAR | KRYEZIU | NEHAT | KRYEZIU | | | V | V | V | | |
| | | NURTEN | KRYEZIU | V | | | | | P | |
| | | | | V | | | | | P | |
| QEMAL | KRYEZIU | ISMET | KRYEZIU | | | V | V | V | | |
| | | ETLEVA | SHEDULLA | V | | | | | P | |
| | | | | V | | | | | P | |
| SELIM | KRYEZIU | ELIAN | KRYEZIU | | | V | ret nga in | V | | |
| | | ILIA | KRYEZIU | V | | | | | P | |
| | | | | V | | | | | P | |
| MYRIBAN | RUSELI | YMID | RESULI (Cërranga) | | | V | V | V | | |
| | | | | V | V | | | | V | |
| AJTEN | SELFO | ARIAN | SELFO | | | V | V | V | | |
| | | REIS | SELFO | V | | | | | P | |
| | | | | V | | | | | P | |
| | | | | | | V | V | V | | |
| LULE | GJURA | | | X | X | | | | | |
| GJON | GJURA | | | V | V | | | | | |
| PJETER | GJURA | | | V | V | | | | | |
| | | | | | | V | V | V | | |
| AHILA | CAKO | | | X | X | | | | | |
| DHESPO | CAKO | | | X | X | | | | | |
| DHIMITER | CAKO | | | V | V | | | | | |
| JANI | CAKO | | | X | X | | | | | |
| JORGJI | CAKO | | | X | X | | | | | |
| VANGJEL | CAKO | | | V | V | | | | | |
| | | | | | | V | Irena dhe | V | | |
| ANTON | KULLAGANI | | | V | | | | | P | |
| IRENA | SPAHIA | | | V | V | | | | V | |
| JOVAN | KULLAGIN | Armando | Kullagjin | | | V | V | V | | |
| | | Mervin | Kullagjin | V | | | | | P | |
| | | | | V | | | | | P | |
| KOSTANDIN | KULLAGIN | Ana | Gorenca | | | V | ren nga in | V | | |
| | | Ardjan | Gorenca | V | | | | | P | |
| | | Kristi | Gorenca | X | X | | | | | |
| | | Xheni | Gorenca | V | | | | | P | |
| | | | | V | | | | | P | |
| | | | | | | | | | | |
| LINDJE | GJETANI | | | V | | | | | P | |
| VALENTINA | SPAHIA | Ali | Spahia | | | V | V | V | | |
| | | Jakup | Spahia | V | | | | | P | |
| | | Natasha | Rota | V | | | | | P | |
| | | | | V | | | | | P | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | V | V | V | | V |
| FEJZULLAH | KRASNIQI | | | V | | | | | P | |
| KADRIJE | KRASNIQI | | | V | | | | | P | |
| KUJTIM | KRASNIQI | | | X | X | | | | | |
| LUMNIJE | KRASNIQI | | | V | | | | | P | |
| NADIRE | KRASNIQI | | | V | | | | | P | |
| SERVETE | ABAZI | | | V | | | | | P | |
| ZIBUSHE | KRASNIQI | | | V | | | | | P | |
| | | | | | | | | | | |
| MUHAMED | KRASNIQI | | | V | V | | | | V | |
| | | | | | | V | V | V | | |
| MAHMUT | ELEZI | MEHMET | ELEZI | | V me zevendoe zevendoe zevendesim | | | | | |

| EMER | MBIEMER | EMER | MBIEMER | KOPJE TE LETER NJOFTIM | NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE | CERTIFI-KATE VDEKJE | CERTIFI-KATE E TRUNGUT FAMILJAR | DESHMI I TRASHGI-MIE | PRO-KURE | CERTIFIKATE PER CDO NDRYSHIM IDENTITETI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | NAFIJE | ISLAMI | V Vertetuar nga vendimi gjyqesor | | | | | | |
| | | SINAN | ELEZI | V Vertetuar nga vendimi gjyqesor | | | | | | |
| | | YLLDIZE | COLLAKU | V | X | | | | | |
| | | ZELIJE | GJINI | V | V | | | | | |
| | | ZOJUSHE | VISHA | X | X | | | | | |
| | | | | V | V | | | | | |
| | | | | | | V | V | V | | |
| AFERDITA | ABAZI | | | V | | | | | P | |
| ANTONETA | URUCI | | | V | | | | | P | |
| ARMAND | PEPA | | | V | | | | | P | |
| DASHURIJE | PEPA | | | V | V | | | | V | |
| IBRAHIM | PEPA | | | V | X | | | | | |
| | | | | | | V | V | V | | |
| MRI | DELIJA | | | V | V | | | | V | |
| ANANTINA | QAFARENA | | | V | | | | | P | |
| ELSA | QAFARENA | | | V | | | | | P | |
| LUCIJE | DELIJA | | | V | | | | | P | |
| NIK(TONIN) | DELIJA | | | X | X | | | | | |
| NIKOLIN | FUSHA | | | V | | | | | P | |
| TEREZINE | FUSHA | | | V | | | | | P | |
| | | | | | | V | V | V | | |
| ESTREF | MYRTEZA | ARTUR | MYRTEZA | | | V | V | V | | |
| | | GRAMOZ | MYRTEZA | X | X | | | | | |
| | | FATOS | MYRTEZA | X | X | | | | | |
| | | ADNAND | MYRTEZA | V | V | e Fatos ka per Artur, Gramoz dhe Adnan , nuk j | | | | |
| | | BUJANA | KALECI | X | X | | | | | |
| | | MIRELA | HALILI | X | X | | | | | |
| | | | | X | X | | | | | |
| Ferit | MYRTEZA | | | V | V | | | | V | |
| PELLUMB | MYRTEZA | | | X | X | | | | | |
| HYSEN | MYRTEZA | | | V | | | | | p | |
| HAXHIRE | FEJZO | ABEDIN | FEJZO | | | V | V | V | | |
| | | BARJAM | FEJZO | V | V | | | | | |
| | | ZHANETA | NAZARKO | | | V | | | | |
| | | LINDITA | FEJZO | V | V | | | | | |
| | | | | V | V | | | | | |
| BARDHYL | MYRTEZA | | | V | V | | | | | |
| KAJMAK | MYRTEZA | | | X | X | | | | | |
| | | | | | | V | ret nga in | V | | |
| Ahmet | Kapa | | | V | V | | | | | |
| Hatixhe | Goce | | | X | X | | | | | |
| Mirate | Pocka | | | V | V | | | | | |
| Muhamerr | Kapa | | | V | V | | | | | |
| Nevruz | Kapa | | | X | X | | | | | |
| Resmije | Kllomollari | | | X | X | | | | | |
| Sadik | Kapa | | | V | V | | | | | |
| Xheko | Zeqo | | | V | V | | | | | |
| Xhemile | Kapa | | | X | X | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | V | V | V | | |
| AHMET | KAZAZI | ALI | KAZAZI | | | V | V | V | | |
| | | FETHIH | KAZAZI | | | V | | | | |
| | | SAIMIR | KAZAZI | V | V | | | | | |
| | | | | V | V | | | | | |
| FEJZIJE | CUFE | | | V | V | | | | | |
| GJYLIJE | MESI | | | V | V | | | | | |
| NEBIJE | BERDICA | RUDINA | HASANI | | | V | rret nga I | V | | |
| | | | | V | V | | | | | |
| REMZIJE | REXHOVAJ | | | V | V | | | | | |
| SABRI | KAZAZI | AVNI | KAZAZI | | | V | V | V | | |
| | | BEHIJE | CURRAJ | V | V | | | | | |
| | | MUHAMET | KAZAZI | V | V | | | | | |
| | | NAIME | HURSHITI | | | V | | | | |
| | | | | V | V | | | | | |
| | | | | | | V | rret nga Init Gjyqesor Durres e cila perca | | | |
| BEQIR | KABASHI | | | V | V | | | | | |
| HYRIJE | EMA (BAJRAKTARI | | | V | | | | | P | |
| HYSMETE | TARI (BAJRAKTARI) | | | V | | | | | P | |
| KUJTIM | BAJRAKTARI | | | V | | | | | P | |
| MERXHIMET | KABASHI | | | V | V | | | | | |
| NAIM | BAJRAKTARI | | | V | | | | | P | |
| NEZIFE | DOCI | | | V | V | | | | V | |
| NERXHIVAN | KABASHI | | | V | V | | | | | |
| ALI | KABASHI | EZMERALDA | KABASHI | | | V | V | V | | |

### “Themelet” u vendosën, dalin fotot e vogëlushit, ja kujt i ngjan

# Për herë të parë prindër! Fansat kritikojnë Elitën dhe Gjikon për emrin e djalit

## *Moderatorja: Gëzim më të madh nuk paska!*

Egla Xhemali

Elita Rudi dhe Gjiko u bënë për herë të parë prindër dhe dje çifti prezantoi vogëlushin me botën. Prezantuesja nga Kosova postoi disa foto me të birin, që erdhi në jetë mbrëmjen e së mërkurës. Buzët si dhe flokët e zinj janë tiparet më dalluese të vogëlushit, ndërsa duket se i sapolinduri është një miksim mes mamit dhe babit. Elita zbulon se e kanë pagëzuar vogëlushin me emrin Zëri, ndërsa në postimin e saj shkruan: "Mbrëmë Zoti na bekoi me djalin tonë Zëri Gjikolli. Oh gëzim më të madh në jetë nuk paska!" Mirëpo emri i veçantë i djalit të tyre ka qenë mjaft i komentuar nga fansat e çiftit. Ndjekësit nuk janë dhe aq dakord për këtë zgjedhje, e cila përkon edhe me emrin e një prej gazetave të shtypit ditor në Kosovë. Halli i tyre është se ky emër i veçantë mund t'i kthehet në një "makth" djaloshit kur të rritet. Nuk kanë munguar edhe ata që kanë bërë humor me këtë aspekt, pasi sipas tyre çifti duhej të mendohej më shumë në përzgjedhjen e emrit. Megjithatë duket se Elita dhe Gjiko nuk kanë në plan të ndryshojnë emrin e birit të tyre që sapo ka ardhur në jetë. Nuk kanë qenë të pakta urimet nga familjarët dhe miqtë e çiftit. Kështu lajmin e bukur e zbuloi mamaja e reperit, Lirije Gjikolli, përmes postimeve në rrjetet sociale. Ajo publikoi një buqetë me lule, e cila ishte e rrethuar me një shirit, ku citohej gjinia e foshnjës me fjalët "Është djalë". "Ndjenjë e papërshkruar, nga sot gjyshe", ka shkruar nëna e reperit në mbishkrimin e fotografisë. Çifti e kurorëzoi dashurinë në shtatorin e vitit të kaluar. Dasma e tyre pushtoi gjithë mediat rozë. Të gjithë ishim kurioz të shihnim Elitën të veshur nuse, kostumin e Gjikos, dekorin e dasmës apo edhe të shihnim sesi ishin veshur të ftuarit. Por, më shumë se kaq, kurioz ishim nëse çifti do të konfirmonte lajmin e shumëpërfolur se Elita është në pritjen e ëmbël. Fustanet e zgjedhur prej saj, me qëllim ose jo, nuk tregonin nëse moderatorja pritej të bëhet nënë, por ka qenë një postim i Gjikos në 'Instagram' që shtoi edhe më shumë dyshimet.





"Sapo i vumë themelet e familjes tonë! Ishalla me shumë beba gruja jem", shkruante reperi krahas fotos ku ngrenë dolli me Elitën. Një atmosferë e jashtëzakonshme në ditën e tyre të shenjtë, gjithçka e menduar deri në detaje dhe një gëzim i papërshkrueshëm për Elitën dhe Gjikon. Elita më vonë kur barku nisi të rrumbullakosej pohoi se po e dashuronte atë periudhë. Bukuroshja vendosi të shfaqet shtatzënë në videoklipin e bashkëshortit të saj. Tanimë çifti janë më të lumtur se kurrë me mbërritjen në jetë të vogëlushit të tyre.





# I habiti të gjithë! Fifi i jep fund beqarisë

Ka shumë kohë që Flori Mumajesi po diskutohet për një lidhje me këngëtaren e njohur Fifi. Mirëpo fjalët u hodhën poshtë nga vetë protagonistët duke u shprehur se janë shumë miq të mirë. Këngëtarja i ka bërë të gjithë lëmsh pasi ka dhënë një lajm shumë të mirë në 'Instastory' dhe bëhet fjalë për kurorëzimin e dashurisë së saj me fejesë brenda muajit mars. Gjithmonë Fifi ka qenë e hapur me ndjekësit e saj dhe nuk kishte sesi ta mbante të fshehur këtë lajm kaq të bukur. Mbrëmjen e kaluar në 'Instastory' ka postuar një foto ku pohon se, ose më datë 3, ose me datë 8 do të fejohet. Me shumë gjasë i referohet muajit të ardhshëm, pra marsit. Dhe duket se nuk është aspak një shaka, pasi emoji me të cilin ka shoqëruar përshkrimin është me sy me zemra. Ky i fundit tregon se ajo vërtet do fejohet dhe mezi po pret!






# Almeda i gjen "sozinë" Tolgës, zbuloni kush është ai

Ish- missi dhe modera torja shqiptare Almeda Abazi para pak muajsh dha lajmin e gëzueshëm që është shtatzënë. Ajo dhe bashkëshorti i saj, aktori i famshëm turk Tolgahan Sayisman po presin fëmijën e tyre të parë dhe e kanë ndarë me publikun lajmin e bukur tashmë. Derisa fëmija të vijë në jetë, Alemda po e shijon çdo sekondë të shtatzënisë dhe është shumë aktive në rrjetet sociale. Së fundmi, ajo ka publikuar në 'Instatory' një foto ku tregon se e ka gjetur sozinë e bashkëshortit, Tolgahanit. Almeda ka bashkuar foton e tij me atë të një maceje, teksa të dy kanë bërë të njëjtën mimikë fytyre, me kokën e ulur dhe sytë përtokë, siç mund ta shihni më poshtë.






# Rudina Magjistari vë në siklet Klea Hutën, ja çfarë ka ndodhur

Ata janë një ndër çiftet më simpatikë në show bizzin shqiptar dhe shumë të dashur për publikun. Fillimisht ata e mbajtën shumë sekrete romancën e tyre, por më pas dolën publikisht me deklarata dashurie dhe shumë mirë bënë. Së fundmi, çifti bëri daljen e parë në TV dhe ishin të ftuar te Rudina. Moderatorja nuk duroi, por që në fillim i kujtoi brunes simpatike sesi ia kishte mohuar fjalët që qarkullonin për ata të dy. Rudinës duket i paska mbetur "peng", se kishte bërë gati dhe videon që tregonte atë moment. "E mban mend herën e fundit që ishe këtu kur të pyeta për Elgitin? E kam bërë atë videon, tha Rudina dhe Klea e kaloi momentin si me të qeshur. Por Rudina vazhdoi: "një ditë përpara ishe në program dhe the "Jo", ndërsa të nesërmen nxorët foto të dy duke e bërë publike", shtoi moderatorja që këmbënguli ta çonte deri në fund idenë e saj!






# Probleme për reperin! Fero dënohet me burg, mësoni të vërtetën

Fero është një ndër repart më IN të momentin dhe shumë i preferuar për publikun. Kjo shihet fare mirë në rrjetet sociale dhe klikimet në youtube, mirëpo siç duket tashmë ai ka probleme dhe është dënuar me burg. Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar me 5 muaj burg me kusht dhe 1.200 euro gjobë, pasi akuzohet për posedim të lëndëve narkotike. Mirëpo e gjitha kjo e ka një të mirë , pasi gjykatësi vendosi që dënimi me burg ndaj tij të mos ekzekutohet, nëse Fero nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti. Fero, gjithashtu, është i detyruar të paguajë 1200 euro gjobë. Mesa duket kjo e ka mërzitur Arbenitën. Shpresojmë që çifti ta kalojë sa më parë këtë gjendje.



### Kamenos: S'trembemi nga Shqipëria, Shkupin 20 minuta punë e kemi

# Ish-ministri grek: Nuk ndjehemi të kërcënuar, mbrojtja s'na ka shqetësuar kurrë



Ish-ministri grek i Mbrojtjes dhe kreu i "Grekëve të Pavarur" Panos Kammenos, në një intervistë për televizionin lokal "TRT" ka thënë se Shkupi është punë e vogël dhe nuk përbën kërcënim për Greqinë. Sipas tij, një njësi e makinave të blinduara për 20 minuta mund të arrijnë deri në kufij me Serbinë. Kammenos tha se as Shqipëria e as Shkupi nuk mund ta kërcënojnë Greqinë. "Nuk ndjehemi të kërcënuar. As Shqipëria nuk mund ta kërcënojë Greqinë, e as Shkupi. Shkupi është 20 minuta punë. Nëse një njësi e makinave të blinduara vendos të kalojë, mund të arrijë deri në kufij me Serbinë. Mbrojtja nuk na ka shqetësuar kurrë", tha Kammenos. Në lidhje me Marrëveshjen e Prespës, ai tha se ish-ministri i Jashtëm Nikos Kotzias, ka vepruar tinëzisht dhe fshehtë dhe se kryeministri grek ka përgjegjësi absolute, pasi siç tha, ka vendosur që në mënyrë tjetër ta udhëheq qeverinë. Ai tha se kur ka qenë në SHBA, ku edhe ka propozuar "Planin B", gjegjësisht marrëveshje me karakter strategjik për vendet e rajonit, sekretari shtetëror në SHBA e ka pyetur: pse insiston? Kammenos ka qenë kundër nënshkrimit të marrëveshjes për zgjidhjen e kontestit të emrin me Maqedoninë, ndërsa është shkarkuar nga posti i ministrit të Mbrojtjes në qeverinë e Alexis Tsiprasit.

> **PANOS KAMENOS**
> "Nuk ndjehemi të kërcënuar. As Shqipëria nuk mund ta kërcënojë Greqinë, e as Shkupi. Shkupi është 20 minuta punë. Nëse një njësi e makinave të blinduara vendos të kalojë, mund të arrijë deri në kufij me Serbinë. Mbrojtja nuk na ka shqetësuar kurrë", tha Kammenos.

### Vuçiç: S'kemi mbështetje për zgjidhjen e problemit, s'ka marrëveshje

# 'Dhurata' për 10 vjet marrëdhënie, Japonia hap ambasadën në Prishtinë

## Vit i suksesshëm, Kosova pritet të hapë ambasada në katër shtete



Një lajm i jashtëzakonshëm është dhënë ditën e djeshme në Kosovë. Ka qenë i pari shteti i Japonisë ai që ka hapur ambasadën në Prishtinë. Një reagim i menjëhershëm ka ardhur nga ministri i Jashtëm i Kosovës Behgjet Pacolli, i cili thotë se kjo është një shenjë e miqësisë mes këtyre dy vendeve dhe tregon se Japonia është një aleat strategjik i Kosovës. "Nder i veçantë të mirëpres në Prishtinë, ministren e shtetit për Punë të Jashtme të Japonisë Abe Toshiko. Japonia është vend që ka dhënë dhe vazhdon të jap shumë për zhvillimin dhe fuqizimin e Republikës së Kosovës. Japonia si vend me interes strategjik për vendin tonë, bën pjesë në mesin e aleatëve të fuqishëm me të cilët në këtë 10 vjetor të marrëdhënieve diplomatike synojmë thellimin e bashkëpunimit bilateral. Lajmi i mirë në këtë drejtim është hapja e ambasadës së Japonisë në Prishtinë që do të hapë një dimension të ri në marrëdhëniet tona. Në shenjë miqësie mes dy popujve tanë, pranë shtatores së Ismail Qemalit, bashkë me ministren Abe dhe kryetarin e Prishtinës z.Ahmeti mbollëm edhe një qershi japoneze", thotë Behgjet Pacolli në një postim në 'Facebook'. Ndërkaq ditën e mërkurë u tha se do të hapeshin brenda vitit katër ambasada në Kosovë. Brenda këtij viti, Kosova do të bëhet me ambasada të Kosovës në katër shtete. Sipas një njoftimi zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, gjatë 2019-s do të hapen ambasadat në Mbretërinë e Tajlandës, në Republikën Popullore të Bangaldeshit, në Republikën e Kolumbisë dhe Republikën e Ganës. "Në vitin e njëmbëdhjetë të ekzistencës së saj si shtet i pavarur, sovran dhe i mirë integruar në komunitetin ndërkombëtar të shteteve, Republika e Kosovës do të vazhdojë të shtrijë dhe përforcojë edhe më shumë rrjetin e saj diplomatik në disa kontinente", thuhet në njoftimin e MPJ-së. Sipas këtij njoftimi, nëpërmjet këtyre misioneve të reja diplomatike, MPJ-ja synon të mbulojë edhe disa shtete të tjera nëpërmjet akreditimeve jo-rezidente, me qëllimin e zgjerimit të bashkëpunimit dhe vendosjes së partneriteteve sipas interesave të përbashkëta. "Ministria e Punëve të Jashtme tashmë ka ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet për procedurat respektive, që ndërlidhen me hapjen dhe funksionalizimin e plotë të këtyre ambasadave", thuhet në njoftim. Por nga ana tjetër lidhur me dialogun me Serbinë, optimizmi i Presidentit serb Aleksandër Vuçiç për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare me Kosovës është zbehur. Në një intervistë televizive, kreu i shtetit serb thotë se çështja e Kosovës nuk do të zgjidhet pavarësisht se vetë është i angazhuar për ta arritur këtë. "Nuk kemi mbështetje për zgjidhjen e problemit të Kosovës. Çdo zgjidhje që do të na ofrohet nuk do të jetë kurrë e mjaftueshme dhe për këtë arsye nuk do të marrë mbështetjen e shumicës në Serbi". Mungesa e një marrëveshjeje me Kosovën bllokon perspektivën europiane të të dy vendeve. Për kreun e Komisionit Europian, mungesa e perspektivës drejt unionit për vendet e Ballkanit Perëndimor do të thotë rikthim në luftërat e viteve '90?. "Vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet t'u japim patjetër një perspektivë të qartë. Nëse ato nuk bëhen anëtare të Bashkimit Europian rrezikojnë të rikthehen në konfliktet e viteve '90. Mendoj që kjo është një çështje mes luftës dhe paqes". Në konferencën e përbashkët për shtyp në Bruksel me Borut Pahorin, presidentin e Sllovenisë, Junkcer ishte në të njëjtën linjë me kreun e shtetit të Kosovës Hashim Thaçi, i cili të mërkurën paralajmëroi se, nëse nuk arrihet një marrëveshje me Serbinë brenda këtij viti, Ballkani rrezikon të përfshihet në një konflikt të ri.

> **ALEKSANDAR VUÇIÇ**
> "Nuk kemi mbështetje për zgjidhjen e problemit të Kosovës. Çdo zgjidhje që do të na ofrohet nuk do të jetë kurrë e mjaftueshme dhe për këtë arsye nuk do të marrë mbështetjen e shumicës në Serbi", - ka thënë presidenti Vuçiç.

> **BEHGJET PACOLLI**
> "Japonia si vend me interes strategjik për vendin tonë bën pjesë në mesin e aleatëve të fuqishëm, me të cilët në këtë 10-vjetor të marrëdhënieve diplomatike synojmë thellimin e bashkëpunimit bilateral. Lajmi i mirë në këtë drejtim është hapja e ambasadës së Japonisë në Prishtinë, që do të hapë një dimension të ri në marrëdhëniet tona", - tha ministri Pacolli.

## SHKURT

### Arrestohet deputeti, Kuvendi pranon heqjen e imunitetit

Pas ndalimit nga ana e policisë së Maqedonisë së Veriut të ish-kryetarit të Parlamentit të Maqedonisë dhe njëkohësisht deputet, Trajko Veljanovski Kuvendi ka pranuar kërkesën e Gjykatës Penale për heqjen e imunitetit të deputetit. Mediat e vendit fqinj bëjnë me dije se pranimi i kërkesës për heqjen e imunitetit të deputetit të VMRO-DPMNE-së është konfirmuar nga kabineti i kryeparlamentarit të Kuvendit, Telat Xhaferi. Sipas procedurave, tani mbetet që kryeparlamentari Xhaferi kërkesën duhet t'ia dërgojë Komisionit për Çështje të Mandateve dhe Imunitetit. Kryetari i Komisionit, Pavle Bogoevski tha se sapo të pranojë kërkesën, do e shqyrtojë atë nëse gjithçka është në rregull dhe më pas do caktojë seancë të Komisionit. Ish-kryetari i Kuvendit dhe tani deputet i VMRO-së Trajko Veljanovski, akuzohet për organizimin e ngjarjeve të 27 prillit. Një akuzë që rrezikon edhe ish-kryeministri tashmë në arrati, Nikola Gruevski.

### Akuzat e prokurorisë, Gruevski: S'kam qenë në Maqedoni

Pas dyshimeve nga ana e prokurorisë se ai mund të fshihej pas sulmit të 27 prillit në Kuvend, ka reaguar edhe ish-kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Nikolla Gruevski. Përmes një postimi në faqen e tij të "Facebook", Gruevski nga arratia shprehet se më datë 27 prill 2017 ka qenë në Vjenë dhe jo në Maqedoni. "As nuk kam organizuar dhe as nuk kam dhënë pëlqimin për askënd që të organizojë një sulm të dhunshëm në Kuvend ndaj deputetëve. Përkundrazi, më parë se të gjithë politikanët, sapo kuptova, kërkova ta qetësoja situatën përmes rrjeteve sociale, sepse atë ditë dhe të nesërmen isha në Vjenë. Unë i bëj thirrje prokurorisë të prezantojë publikisht provat kundër meje. Le të shohim dëshmitë materiale ose çfarëdo prove, qofshin ato nga ndonjë dëshmitar i rremë, i parëndësishëm ose i shantazhuar, ose ndonjë i dyshuar, i cili është i rrezikuar ose i akuzuar në një rast të caktuar. Dua të dëgjoj publikisht se si nga pozita e kryetarit të VMRO-DPMNE-së paskam ndikuar tek ministri Nuhiu",- shkruan mes tjerash Gruevski.

Përplasja me Trump, e vërteta e konfliktit mes presidentëve

# Kriza në Venezuelë: Pse ndodhi kolapsi?

## Eksodi i venezuelianëve, nafta dhe përçarjet e tjera në vend

Presidenti venezuelian Nicolas Maduro të mërkurën i dha diplomatëve amerikanë 72 orë për t'u larguar nga vendi në përgjigje të vetëshpalljes së kryetarit të Asamblesë Kombëtare president të vendit, në mes protestave masive. Disa orë pasi Presidenti Donald Trump zyrtarisht njohu kreun e opozitës Juan Guaido si president legjitim të vendit, Maduro sfidues u shfaq përpara mbështetësve për të akuzuar Shtetet e Bashkuara si mbështetëse të një grushti shteti. Maduro njoftoi se po priste lidhjet e mbetura politike dhe diplomatike me Uashingtonin. "Ne nuk mund të pranojmë politikat pushtuese të perandorisë, Shteteve të Bashkuara, politikat e Donald Trump", tha ai mes brohoritjeve nga turma. "Venezuela është një vend i çlirimtarëve." "Ne nuk do të dorëzohemi",- shtoi Maduro. Po si është shpalosur kriza dhe si ka mbërritur Venezuela deri në këtë pikë?

### PSE NDODHI EKSODI?

Ekonomia dhe rendi shoqëror i Venezuelës po pësojnë kolaps, duke lënë 75 për qind të popullsisë së varfër dhe pa ushqim të mjaftueshëm. Monedha fizike, bolivari, është e pavlerë, ndërsa petro - monedha e re dixhitale që presidenti socialist Nicolás Maduro prezantoi vitin e kaluar, e lidhur me çmimin e naftës - është kryesisht fiktive. FMN parashikon që inflacioni i vendit mund të arrijë 10 milionë për qind këtë vit. Jo se ka shumë për të blerë: Raftet e dyqaneve janë bosh, dhe ushtarët ruajnë depot kundër plaçkitësve. Shumica e venezuelianëve tani janë të privuar nga proteina, dhe ata "tallen seriozisht" për "dietën e Maduro", që i ka lënë të rriturit të hollë dhe fëmijët të kequshqyer. Spitaleve u mungojnë ilaçet dhe furnizimet bazë, dhe pacientëve që do kryejnë ndërhyrje kirurgjikale, u është thënë të sjellin produktet e tyre të pastrimit dhe fashot. Shkalla e vrasjeve është rritur me 15 herë më shumë se sa mesatarja globale dhe krimi është i shfrenuar. "Të vjedhin në rrugë, në plazh, në treg, në spital", -thotë mësuesi Yamileth Marcano. "Është e tmerrshme të jetosh kështu".

### ÇFARË E SHKAKTOI KOLAPSIN

Regjimi radikal socialist i ngritur nga Hugo Chavez funksionoi mirë për disa vitederisa e shkatërroi vendin. I zgjedhur për herë të parë në vitin 1998, Chavez rishpërndau tokat e vendit dhe pasurinë masive të naftës për të përfituar të varfrit, duke financuar programet e tij përmes shtetëzimit të industrisë së naftës, e cila tani përbën 98 për qind të të ardhurave nga eksporti dhe bankat. Por kontrollet e tij të çmimeve mbytën bizneset e vendit, dhe deri në kohën kur Chavez vdiq në vitin 2013, inflacioni ishte rritur me gati 50 për qind. Më pas, çmimet globale të naftës ranë në mënyrë dramatike, duke lënë pasuesin e tij, Maduro, me një recesion që u shndërrua në krizë. Pa vërshimin e dollarëve të jashtëm të naftës që do të përdoreshin për të blerë produkte, importet shteruan dhe raftet e nevojave themelore u zbrazën. Ndërkohë, vendi u bë një narko-shtet, me shumë gjeneralë të lartë dhe politikanë - përfshirë ish-nënpresidentin Tareck El Aissami - të paditur në SHBA për trafikun e drogës dhe pastrimin e parave. Në vend që t'i adresonte këto probleme në mënyrë pragmatike, Maduro i shpenzoi energjitë e veta për të shtypur kundërshtimet dhe parandaluar një grusht shteti.



### SI MBIJETOI?

Përmes ushtrimit të dhunshëm të pushtetit. Opozita fitoi zgjedhjet parlamentare në vitin 2015 dhe tani dominon Asamblenë Kombëtare. Por Maduro prezantoi ndryshime që gërryenin fuqinë e Kuvendit; ai pastaj krijoi një Asamble të re Kushtetuese, të mbushur me përkrahësit e tij, për të rishkruar Kushtetutën. Nën maskën e një spastrimi kundër korrupsionit, ai hoqi besnikët kryesorë të Chávezdit; ai pastaj krijoi një Asamble të re Kushtetuese, të mbushur me përkrahësit e tij, për të rishkruar Kushtetutën. Nën maskën e një spastrimi kundër korrupsionit, ai hoqi besnikët kryesorë të Chávezit, që mund ta sfidonin atë, siç ishte ish-shefi i naftës shtetërore, Rafael Ramirez dhe burgosi udhëheqës karizmatikë të opozitës si Leopoldo López. Kur ushtria filloi të bëzante, Maduro e spastroi atë brutalisht. Shtatë gjeneralë, të cilët kontrollonin së bashku 60 përqind të trupave, u arrestuan marsin e kaluar në akuzat e komplotit. "Jo vetëm që agjentët e inteligjencës arrestojnë dhe torturojnë pjesëtarë të ushtrisë"-thotë José Miguel Vivanco i Human Rights Watch, "në disa raste ata shkojnë edhe tek familjet e tyre ose civilë të tjerë".

### PSE NUK ISHIN NGRITUR NJERËZIT?

Protestat filluan seriozisht në vitin 2014, një vit pasi Maduro mori detyrën dhe ato janë ndezur çdo vit që nga ajo kohë. Por regjimi i ka shtypur me dhunë këto demonstrata. Policët dhe bandat e armatosura pro-qeveritare, të njohura si colectivos, zakonisht rrahin, përdorin gaz lotsjellës, dhe madje edhe qëllojnë demonstrues. Qindra janë vrarë dhe mijëra janë arrestuar. Vitin e kaluar, ka pasur rezistencë shumë më pak të organizuar, pjesërisht për shkak se udhëheqësit e opozitës janë në mërgim ose të burgosur dhe pjesërisht për shkak se venezuelasit janë kryesisht të fokusuar në marrjen e ushqimit dhe mbijetesës ose largimin nga vendi. Që kur Maduro mori detyrën, gati tre milionë njerëz kanë emigruar rreth 7 për qind e popullsisë. Dhe eksodi vazhdon. "Duke marrë parasysh madhësinë e krizës së Venezuelës"-thotë Luis Almagro, sekretar i përgjithshëm i Organizatës së Shteteve Amerikane, "mund të ketë deri në 10 milionë venezuelanë që do të duhet ta braktisin atë vend".

### KU KANE SHKUAR?

Më shumë se një milion janë në Kolumbinë fqinje, një gjysmë milioni janë në Peru, dhe shumica e pjesës tjetër kanë përfunduar në Ekuador, Argjentinë, Kili dhe Brazil. Në fillim, Kolumbia reagoi ndaj fluksit venezuelian me bujari, duke u ofruar imigrantëve leje pune dhe kujdes shëndetësor. Por me rreth 5,000 njerëz në ditë që lënë Venezuelën, qytetet kufitare thjesht nuk mund të përballojnë. "Ne po përjetojmë krizën më të egër migratore dhe humanitare në historinë e kohëve të fundit në rajon",-tha presidenti kolumbian Iván Duque në OKB vitin e kaluar.

### A DO NDERHYJNË TË TJERËT?

Pasi Maduro fitoi një mandat të ri gjashtëvjeçar vitin e kaluar në zgjedhje të manipuluara, 12 vende të Amerikës Latine, duke përfshirë Kolumbinë dhe Brazilin, thanë se nuk do ta njohin administratën e Maduros dhe janë zotuar ta izolojnë atë. Por një pushtim ushtarak nuk ka gjasa të ndodhë. Venezuela ende ka mbështetjen e aleatit socialist, Kubës, ndërsa Kina i ka dhënë kredi dhe Rusia ka ofruar ndihmë ushtarake. Ndryshimi do të duhet të vijë nga brenda. Asambleja Kombëtare e kontrolluar nga opozita nxori këtë vit një udhëheqës të ri, Juan Guaidó, i cili sot po njihet nga shumë vende me në krye Amerikën, si presidenti i ri i Venezuelës.

### IMPORTI I NAFTËS VAZHDON

Shtetet e Bashkuara dhe Venezuela kanë lidhje të thella ekonomike dhe energjetike, por marrëdhëniet u përkeqësuan në vitin 2015, kur administrata e Obamës shpalli autoritarizmin e Maduro-s si një kërcënim për sigurinë kombëtare të SHBA dhe goditi venezuelasit me sanksione. Administrata e Trump shkoi edhe më tej, duke ngrirë pasuritë në SHBA të Maduros dhe zyrtarëve të tij të lartë bashkë me kompanitë e tyre, si dhe duke sanksionuar eksportet e arit të Venezuelës, kriptomonedhën e saj dhe kompaninë më të madhe të saj mediatike, Globovision. Maduro ka fajësuar sanksionet amerikane për problemet e vendit të tij, duke thënë se SHBA po zhvillon "luftë ekonomike" kundër tij. Por, edhe pse tensionet janë të larta, administrata Trump ka refuzuar të vendosë sanksione ndaj naftës venezueliane. Venezuela mbetet një nga pesë furnizuesit më të mëdhenj të naftës së huaj në SHBA dhe rafineritë në Bregun e Gjirit të Madh varen shumë nga nafta bruto, e shtetit të Amerikës së Jugut. Më e rëndësishmja, vendosja e sanksioneve ndaj burimit të vetëm të mbetur të Venezuelës me siguri do të shkaktonte kolaps.

*Marrë nga Bota.al*

## "VRITENI ZEZAKUN", SALVINI REAGON NDAJ NENES PAS SULMEVE RACISTE

**"Ajo që po ndodh në Itali, është në kuadër të politikave të Matteo Salvini", është shprehur Angela Bedoni, nëna adoptive e Bakary Dandio, 22 vjeçar senegales, pas shkrimeve raciste 'Vriteni zezakun', shfaqur në muret e pallatit ku jeton familja milaneze. Por nuk ka vonuar edhe një përgjigje nga ministri i Brendshëm, Matteo Salvini: Respektoj dhimbjen e nënës, përqafoj djalin e saj dhe dënoj çdo episod racizmi. Por të bllokohen skafistët dhe bashkëpunëtorët e tyre, të ndalohet emigracioni klandestin, të instalohen telekamera dhe të përjashtohen kriminelët dhe të bëhet vetëm drejtësi, nuk është racizëm aq më tepër fashizëm.**




## SHKURT

### Itali, arrestohet nipi i bosit të mafies kataneze

Ditën e djeshme janë arrestuar dy eksponentë të klanit Cursoti Milanesi, të akuzuar si përgjegjës për një shantazh në dëm të një farmacie në Katania. Në pranga kanë përfunduar Alfio Napoli 47-vjeç nipi i bosit historik të Luigi Miano, i njohur si 'Jimmy' dhe Vincenzo Piazza 43-vjeç. Arrestimi u bë në sajë të hetimeve të prokurës rajonale të antimafias të Katanias dhe seksionit të krimeve kundër pasurisë, për episodet e shantazheve nga segmente të klanit "Curseti Milanese' në dëm të pronarit të farmacisë. Tg.com shkruan se farmacia ishte e detyruar të paguajë që në vitin2009, përmes postës mujore, 200 euro në muaj.

### Venezuelë, Maduro dërgon makina të blinduara në kufi me Brazilin

Presidenti i Venezuelës, Nicola Maduro ka dërguar një makinë të blinduar drejt qytetit të Santa Elena de Uairen, në kufi me Brazilin, për të evituar hyrjen e mjeteve të ndihmës humanitare ndërkombëtare të Pacaraima, qytet brazilian në pjesën tjetër të kufirit. Vendimin e Presidentit Maduro e kanë bërë me dije banorët vendas, të cilët kanë publikuar imazhe të makinave të blindar në rrjete sociale. Fotot më pas janë shpërndarë disa herë, për t'u publikuar më pas në mediat lokale. "Karakas ka vendosur të 'rishikojë' marrëdhëniet diplomatike me antilet Holandeze, Aruba, Bonaire dhe Kuracao", ka bërë me dije, Delcy Rodriguez, zëvendësuesi i presidentit në ngarkim, Nicola Maduro.

### Arabia Saudite do të lirojë 850 të burgosur shtetas të Indisë

Riadi zyrtar do të lirojë 850 shtetas të Indisë nga burgjet e tij pas një kërkese nga kryeministri Narendra Modi gjatë vizitës së princit kurorës Mohammed bin Salman në Nju Delhi, njoftoi sot Ministria e Jashtme e Indisë. Burgjet saudite mbajnë numrin më të madh të shtetasve të Indisë të burgosur në botë. Që nga janari 2019, 2.224 shtetas të Indisë u burgosën në mbretëri për krime, përfshirë vrasje, rrëmbim, ryshfet, mashtrim, drogë dhe alkool, sipas shifrave të Ministrisë së Jashtme të Indisë. Rreth 2.7 milionë shtetas të Indisë në Arabinë Saudite formojnë komunitetin më të madh të emigrantëve në mbretëri, ku shumë punojnë me pagë të ulët në sektorë të tillë si ndërtimi, shërbimet vendore dhe shitjet me pakicë. Të hënën, Arabia Saudite urdhëroi lirimin edhe të rreth 2.100 të burgosurve pakistanezë nga burgjet, sipas ministrit pakistanez të informacionit.

ANALIZA

Ç'ka mund të presë Prishtina, ç'ka mund të presë Kosova prej përbërjes së tillë të delegacion-it, në të vërtetë të katër delegacioneve të saj? Ç'ka mund të presin Kosova dhe shqiptarët nga ky absurd e nga ky joseriozitet e nga kjo papjekuri shtetërore? E nga kjo komedi?

# REXHEP QOSJA:

# Katër delegacionet e Kosovës në bisedimet me Serbinë, një komedi!

Nga prof.Rexhep QOSJA*



"Shtetet e mëdha a të vogla, zakonisht udhëhiqen prej një kryetari"

1.Ka një krizë dhe ka shumë paqartësi në bisedimet e filluara tash e sa vjet ndërmjet dy shteteve të cilat para nëntëmbëdhjetë vjetësh ishin në luftë: ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Në mendjet e përfaqësuesve të këtyre dy shteteve, historia e të cilave është e ngarkuar me shumë drama, tragjedi dhe dhembje të shumëllojshme të mesvetshme, e sidomos me pushtimin serb të Kosovës, me kolonizimin serb të Kosovës, me planet për shpërnguljen e detyrueshme të shqiptarëve në Turqi, me dhunën dhe terrorin e Sigurimit të Brendshëm Shtetëror (UDB-së) mes viteve 1950-1965, me dhunën e terrorin e regjimit të Milloshevicit pas demonstratave të vitit 1981 dhe, mandej, me zhvendosjen e dhunshme të rreth një milion shqiptarëve në vitet 1998-1999, duhet të zotërojë vetëdija për gjendjen e pandryshueshme gjeografike mes tyre: Kosova dhe Serbia janë fqinje dhe do të jenë përgjithmonë shtete fqinje.

Në vetëdijen për këtë gjendje duhet të ndikojnë shumë të dhëna, e njëra prej të cilave është: Serbia kurrë nuk do të mund ta çojë Kosovën të themi, në Indonezi, kurse Kosova kurrë nuk do të mund ta çojë Serbinë, të themi, në Australi.

Fqinjësia është, pra, fati apo fatkeqësia e tyre e përbashkët.

Ky fat apo kjo fatkeqësi duhet të na e mbushë mendjen të gjithëve -shqiptarëve dhe serbëve se duhet të bëhet krejt ç'mund të bëhet, krejt ç'mund të bëhet pa u cenuar interesat shoqërore, kulturore, kombëtare, të përgjithshme, që fqinjësia të bëhet jo fatkeqësi po, në mos jo fat, së paku një gjendje e durueshme, toleruese, ndërsjellshme, e qytetërueshme me kohë, dikur, bashkëpunuese.

Dhe, rrjedhimisht, vetëdija për sa u theksua duhet t'ua mbushë mendjen atyre që marrin pjesë në bisedimet midis Prishtinës dhe Beogradit se është mirë të bëjnë çmos që të arrihet marrëveshje me të cilën do të normalizohen marrëdhëniet mes tyre, që të arrihet, më në fund, marrëveshje historike, që do ta përfundojë historinë aq shpesh tragjike mes shqiptarëve e serbëve.

Vetëm ngrirja e marrëdhënieve mes tyre, vetëm ngrirja e marrëdhënieve të sotme mes Kosovës dhe Serbisë, nuk është në dobinë as të Kosovës e as të Serbisë, në mënyrë të veçantë as të Kosovës.

2.

Pjesëmarrja e Prishtinës në bisedimet me Beogradin prej fillimeve nuk ishte pjesëmarrje përkatëse! Pjesëmarrja e Prishtinës në këto bisedime prej fillimeve në të vërtetë ishte pjesëmarrje diletante dhe ishte e tillë, diletante, sepse ishte e privuar prej vetëdijes për përgatitje politike, diplomatike, shtetërore, të përtashme dhe historike. Dëshmi për këtë nuk është vetëm pajtimi për krijimin e Bashkësisë së Komunave Serbe, të cilën me të shpejtë, me shumicën e paragrafëve të saj, do ta rrëzojë Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Dëshmitë për këtë janë më të shumta dhe ato janë thënë prej disa juristëve, disa historianëve, disa analistëve, por edhe prej disa prijësve për partiakë opozitarë. Dhe kjo nuk është dëshmia e vetme. Edhe trajtimi i çështjes së përcaktimit të kufijve ndërfqinjësorë përfushi, fatkeqësisht, shumë dobësi të përfaqësuesve tonë në bisedimet me Serbinë dhe jo vetëm mosnjohje, papërgatitje, diletantizëm e çka jo tjetër, që si të tilla pashmangshëm se do të sillnin dështim e humbje për ne, siç edhe sollën.

Sa e si po tregohet e përgatitur sot Kosova për këto bisedime me Serbinë, që pashmangshëm do të fillojnë, pa shumë vonesë?

Në disa pikëpamje po tregohet më mirë e në disa pikëpamje po tregohet dobët si deri sot!

Në bisedimet me Beogradin, Prishtina, që deri para disa muajsh nuk kishte fare delegacion të pranuar prej Kuvendit të saj, tani do të marrë pjesë me delegacionin e krijuar prej Kuvendit të Kosovës, që e udhëheqin dy kryetarë!

Por, në këto bisedime Prishtina nuk do të marrë pjesë vetëm me këtë delegacion.

Jo.

Në këto bisedime Prishtina do të marrë pjesë edhe me një delegacion njëanëtarësh, të cilin e kryeson kryetari i Kosovës.

Në bisedimet e ardhshme me Beogradin, Prishtina do të marrë pjesë, pra, me dy delegacione dhe me tre kryetarë, të këtyre dy delegacioneve!

Delegacionin e ligjshëm, të krijuar prej Kuvendit të Kosovës, e udhëheqin: kryetari i Lëvizja Nisma, Fatmir Limaj, dhe kryetari i Partisë Social-demokrate, Shpend Ahmeti, kjo domethënë se delegacionin e Kosovës në ato bisedime e udhëheqin përfaqësuesi i partive që përbëjnë Pozitën, në njërën anë, dhe përfaqësuesi i partive që përbejnë Opozitën, në të vërtetë që përbëjnë vetëm pakicën e Opozitës, në anën tjetër!

Delegacionin e pazgjedhur në Kuvend, të përbërë prej një anëtari e udhëheq kryetari i Kosovës, që është njëkohësisht anëtar dhe kryetar i këtij delegacioni!

Domethënë: Kosova shtet merr pjesë në bisedimet me Beogradin me dy delegacione, të udhëhequra prej tre kryetarëve, e kjo domethënë me tri delegacione të udhëhequra prej tre kryetarëve të tyre!!! A është parë kund në botë një këso komedie?!

Le të thuhet se një "delegacion" pothuaj të veçantë në bisedimet mes Prishtinës dhe Beogradit e përfaqëson edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, deklaratat e të cilit për Kosovën në bisedime dhe për Kosovën pas bisedimeve janë më mospajtuese, më të forta, më jehuese, në Uashington dhe në Bruksel sesa deklaratat e dy kryetarëve, në të vërtetë të tre kryetarëve të tjerë të delegacioneve: sesa deklaratat e kryetarit të Kosovës, sesa deklaratat e Fatmir Limajt dhe sesa deklaratat e Shpend Ahmetit.

3.

Çka mund të presë Prishtina, çka mund të presë Kosova prej përbërjes së tillë të Delegacionit, në të vërtetë të katër delegacioneve të saj? Çka mund të presin Kosova dhe shqiptarët nga ky absurd e nga ky joseriozitet e nga kjo papjekuri shtetërore? E nga kjo komedi?

Ndoshta sigurisht më pak të mira e më shumë të këqija.

Në këtë Botë, në këtë planet që i thonë Tokë, delegacioni shtetëror, politik dhe diplomatik, pavarësisht sa mund të jenë shtetet e mëdha a të vogla, zakonisht udhëhiqet prej një kryetari. Kështu, prej një kryetari janë udhëhequr dhe udhëhiqen delegacionet shtetërore, politike e diplomatike të SHBA-së, të BE-së, të Rusisë, të Kinës, të Indisë, të Turqisë, të Brazilit, të San Marinos, të Zelandës së Re, të Xhibutit. E të tjera.

A mendojnë kryetarët e këtyre delegacioneve të Kosovës, a mendojnë delegatët e Kuvendit të Kosovës, a mendojnë ministrat e shumtë dhe zëvendësministrat edhe më të shumtë të Qeverisë së Kosovës çka e si mendohet për ta, për përfaqësuesit tonë në Bashkimin Evropian, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kudo tjetër në Botë? Çka mendohet në të vërtetë për institucionet e Kosovës, për Kosovën dhe për shqiptarët?

Po të mendonin nuk do të lejonin që Kosova ta luajë këtë lojë tragjikomike tre-katër ekipore politike, diplomatike, shtetërore, kombëtare në Teatrin e Madh Politik Evropian sot!

Po të mendonin si duhet, çka duhet e sa duhet, nuk do të lejonin që Kosova të punojë kështu siç po punon me katër ekipe delegatësh e kryetarësh me katër-pesë qëndrime kundër vetes!

Të parët, kryetarët e këtyre delegacioneve tona në bisedimet mes Prishtinës e Beogradit, sidomos kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe kryetari i Kosovës, që japin deklarata aq mospajtuese për kushtet në sajë të cilave do të arrihet marrëveshja historike mes Kosovës dhe Serbisë, në të vërtetë mes shqiptarëve dhe serbëve, tregojnë, si u pa, pajtim në prapaskena, në ndeja e gosti të ndryshme netëve të gjata të dimrit.

Por, populli e ka një fjalë të urtë për ata që zihen mes vete Ditën e pajtohen (bashkëpunojnë) Natën, siç që unë s'po e them këtu se e dinë të gjithë.

Kosova duhet të ketë Vetëm një Delegacion dhe Vetëm një Kryetar të këtij delegacioni dhe ky Delegacion me një Kryetar duhet të ketë një Qëndrim për marrëveshjen me delegacionin e Serbisë. Vetëm kështu, me një Delegacion që ka vetëm një Kryetar, që ka vetëm një platformë dhe vetëm një qëndrim të përbashkët, Kosova mund ta përfaqësojë dinjitetshëm Kosovën dhe mund t'i kontribuojë ndryshimit të përfytyrimit të sotëm për të dhe përmirësimit të prestigjit të saj në Botë, sot mjerisht shumë të keqësuar.

Vetëkuptohet se përgjegjshmëria politike i privon nga mundësia për të qenë kryetar apo, madje, anëtar i Delegacionit të tanishëm ata që i kanë vendosur: për marrëveshjen mbi krijimin e Bashkësisë së Komunave Serbe, të cilën e shpalli të pavlefshme Gjykata Kushtetuese e Kosovës, për Marrëveshjen mbi demarkacionin me Malin e Zi me të cilën Kosovës i tjetërsohen dis amija hektarë tokë, dhe për pranimin, shpranimin dhe prapë pranimin e Gjykatës Speciale në të cilën dënohen pjesëtarë të UÇK-së!

***Titujt janë të redaksisë. Titulli origjinal "Delegacionet tona në bisedimet Prishtinë-Beograd".**

LETRA

# MEHMETI: Nuk ka rrugë të gabuara, mos ndiq shtigjet e zilisë

Kim Mehmeti

E dashur,

Doja të të shkruaj për atë që mësova nga leximi i mijëra librave si dhe të ta shpalos shkurtimisht atë që doja ta them nëpërmjet mijëra faqeve që kam shkruar e botuar. U habita kur pashë se tërë atë që di dhe që kam dashur ta them mund ta përfshij në këto pak faqe dhe në këto disa thënie të mëposhtme.

- Të bësh çmos që mos plakesh qysh në rini!

- Njeriu duhet të mësojë të jetë i kënaqur me atë që ka dhe atë që është, sepse vetëm kështu mund të arrijë edhe atë që ëndërron!

- Të mençur janë vetëm ata që e kanë kuptuar se sa i përket diturisë, njeriu ndahet nga kjo botë duke marr me vete aq urtësi, sa merr ujë notuesi në oqeanin e paskajshëm: vetëm ato pak pika që i janë ngjitur në trup gjatë notimit!

- Kurrë mos bëj veprime i prirë vetëm nga dëshira që të jesh i pëlqyer nga të tjerët, por bë atë që ua ke borxh të dashurve tu dhe vetvetes, atë që nëse jo të mira, të tjerëve nuk do u sjellë asnjë të keqe, bëj pra vepra nga të cilat, nëse nuk do kesh pse të mburresh, mjafton të mos kesh asnjë arsye pse të turpërohesh nga ato! Më në fund, njeriu vlen vetëm aq sa do mundet gjatë jetës të mbetet i tillë, siç i pëlqen vetvetja, e jo i atillë, siç do e pëlqenin të tjerët!

- Në thellësinë e tyre, ditët festive, përmbajnë Lumturi Dhembje: lumturinë që na dhurojnë të dashurit tanë, që i kemi shëndosh e mirë pranë vetes si dhe dhembjen, që e ndjejmë për gjithë ata që na mungojnë dhe për njerëzit me kalendar jetësorë pa ditë festive!

- Njeriun nuk e lë pa gjumë ajo që e dinë të tjerët për të, por gjërat që i fsheh nga bota dhe jeton me frikën se ato një ditë do të mund të zbulohen!

- Urtësi mbi të gjitha të tjerat është të kuptosh se që nga dita e lindjes e tutje, ti nuk i takon vetëm vetvetes! Se është mjeshtri që jashtë njerëzve të gjakut tënd familjar, të gjesh ata të cilët me vetëdëshirë do i shpallësh pronarë të një pjese tënden dhe të vdesësh me bindjen se nuk ke bërë zgjedhje të gabuar! Kjo është ajo përmbajtje që dëshmon se ke jetuar Mrekullinë tënde, se i je përmbajtur Mitologjisë vetjake ku më e rëndësishme është kaptina me mbititull: 'Mos e merr nga të tjerët me dhunë atë që ata nuk duan të ta japin, dhe mos ua jep atë që ata nuk dinë ta vlerësojnë!

- Thonë se jeta është rrugicë që të çon tek vdekja, ndërkaq vdekja është vendshkarkim i vuajtjeve jetësore! Në ndërkohë duhet shtuar se këtë rrugë, dikush e ecë me përulësin e të pikëlluarit pse s'do vdesë me pastërtinë e të palindurit fare, e dikush me kryelartësinë e atij që nuk e ka kuptuar se rrugëtimi drejt vdekjes ka vetëm një kuptim - ta arsyetojë lindjen! Më në fund, nga mënyra si kemi ecë drejtë fundit të jetës, ne e përcaktojmë se cili e ka arsyetuar lindjen dhe ka vdekur, e cili ka 'ngordhur'



*Letër mikeshës sime: Nga dita e lindjes e tutje, ti nuk i takon vetëm vetvetes*

- Nuk ndërtohet parajsa me muratorët e ferrit!

- Nuk ka rrugë të patejkalueshme dhe të gabuara, por ka udhëtarë të cilët, në vend se udhës që do i çojë drejt arritjes së paqes me vetveten, nisen shtigjeve që do u ofrojnë zilinë dhe lëvdatat e të tjerëve!

- Komunistët e dikurshëm ishin të dehur nga ideologjia, andaj donin ta 'vrisnin' Zotin! Ndërkaq 'hajdutokratët dhe tenderokratët' e sotëm, të verbëruar nga ngjyra e parasë, i 'vrasin' vlerat më fisnike njerëzore!"

- Të padjallëzuarit dhe ëndërrimtarët janë gjahu më i lehtë dhe më i dëshiruar i intrigantëve dhe i varrtarëve të ëndrrave

Kur je injorantë dhe i pavlerë, si dhe kur 'lavdinë' e djeshme e përdorë si 'kartë-kredie' për ta mbuluar hajninë dhe për ta blerë të sotmen politike, herdo-kurdo 'kartela' të zbrazet dhe përballesh me të vërtetën se nuk ka pasuri apo pushtet, që ta mbulon 'varfërinë' morale dhe njerëzore!

- Më e keqe se varfëria është mallkimi që u takon atyre të cilët duke i ikur skamës, shkelin mbi burrërinë e vet, dhe pranojnë që fëmijët t'i ushqejnë me fatkeqësinë e të tjerëve!

- Fare nuk lexojmë, e aq shumë flasim dhe shesim mençuri! Sikur të lexonim nga një libër në vit, do vinte dita kur do e kuptonim sa shumë rrëfen heshtja dhe, sa i mençur është ai që di të dëgjojë!"

- Kjo botë nuk do ishte e njerëzishme as kaq sa është, sikur të mos kishte ëndërrimtarë që nuk i tradhtojnë ëndrrat e tyre, e që i mbajnë gjallë iluzionet! Andaj, ia vlen t'i mbetsh besnik ëndrrës edhe kur e dinë se ajo është gënjeshtare, por shumë, shumë njerëzore!

- Njeriu i paarsimuar sheh qartë vetëm vetveten dhe gjërat rreth tij, gjysmë i arsimuari nuk e sheh vetëm atë që shikon por edhe hijet që i duken se ecin pranë tij, ndërsa i arsimuari i mirëfilltë nuk e lodh shikimin me gjërat që ka pranë vetes, por donë t'i sheh largësitë, jeton me bindjen se gjithmonë do mbetet vetëm një nxënës që duhet të mësojë.

- Përmendorja e lavdisë, nuk ndërtohet me para nga kuleta e hajnisë!

- Burri nuk vdes kur jep shpirt, por atë ditë kur fillon të mos turpërohet nga asgjë!

- Nëse votuesit shqiptarë do e kishin më të zhvilluar guximin se sa nënshtrimin, atëherë edhe politikanët tanë do i kushtonin më shumë rëndësi ndershmërisë se sa hajnisë!

- Si dje, edhe sot e nesër, duhet të vazhdojmë t'i ëndërrojmë të gjitha ato që duam të na ndodhin, por duke e ditur se jetën e meritojnë dhe denjësisht e jetojnë vetëm ata që e kanë kuptuar se, sikur jeta të mbushej vetëm nga ato që dëshirojmë, atëherë do shembeshin dy shtyllat më të rëndësishmet që atë e mbajnë në këmbë - ëndrrat e shpresat!

- Botuesit dhe shkrimtarët tanë vazhdojnë të japin shpjegime nga më të ndryshmet pse bie lexueshmëria dhe shitja e librit! E në të vërtetë, çdo gjë është shumë më e thjeshtë e më e dukshme seç e thonë ata: në "Shqipëritë" tona, më lirë të kushton ta blesh një diplomë, se sa një libër!

- Është e njohur thënia se vetëm gjatë rinisë njeriu jeton me fytyrën që ia ka dhënë Zoti! Dhe se gjatë jetës së mëtejme, njeriu vetë e zgjedh fytyrën që don ta ketë! Pra, njeriu lind e rritet me fytyrën që ia ka dhënë Zoti, por plaket e vdes me fytyrën që e ka zgjedhur për vetveten: me atë të turpit, apo atë të njerëzores!

- Je më i mbrojtur, më i sigurt, e më i pëlqyer, kur mbanë anën e të pushtetshmin dhe kur ke mik të fortin, të pasurin e të famshmin! Por, miqësia e mbështetur vetëm mbi themelet e frikës dhe interesit, është pasqyrë ku shihet dobësia e individit! Kështu që, kanë qenë, e do mbeten të fortë e të njerëzishëm, vetëm ata që e mbrojnë, e ndihmojnë dhe janë në anën e të dobëtit, të dëmtuarit dhe skamnorit!

- Të kërkosh nga politikanët shqiptarë besnikëri dhe mbajtje të fjalës së dhënë, është njësoj si të kërkosh ndërgjegje nga ai që nuk ka turp!

- Nuk ndërtohet parajsa me muratorët e ferrit!

- Mitet janë si stoli vezulluese dhe të shtrenjta, jo gjithmonë të bëra prej metali të çmuar, por çdoherë të lara në ujë prej ari! Pra, brendia e të vërtetave për ta, është e mbështjellë edhe me gënjeshtra joshëse, që e kanë mirëmbajtur boshtin kurrizorë, si dhe dinjitetin dhe krenarinë, e pjesëtarëve të një etnie, apo të një feje. Të këtilla janë edhe mitet tona shqiptare, përfshi edhe atë për Skënderbeun, që ka jetuar e luftuar në kohë kur janë bërë lufta fetare, e jo etnike, e për nënën e të cilit debatohet këto ditë. Dhe ndaj miteve duhet të sillemi si pronari i stolisë së shtrenjtë të praruar: duke e pastruar kujdesshëm atë, që të mos e gërvishtim, ngaqë do mund edhe të ndryshket! Edhe atë jo gjithaq pse do e dëmtojmë stolin (lexo: mitin), por pse kështu do mund ta dëshpërojmë pronarin, që e ka ruajtur atë si diçka më të shtrenjtë që ka pasur dhe me të cilën është stolisur në ditë kremteje!

- Më mirë është një ditë ta jetosh si luan, se sa tërë jetën ta kalosh i fshehur në birën e miut!

- Nuk është e thënë mëkot: sa më i vogël është një populli, aq më të gjatë e ka himnin dhe aq më të larta i ka përmendoret! Kësaj thënie duhet shtuar: sa më i vogël është një popull, aq më të shumtë i ka heronjtë dhe më të begatë e ka historinë, ku i përshkruan të këqijave që ia kanë bërë armiqtë!

- Shpesh dëgjoj pyetjen: pse politikanët shqiptarë, edhe pse vëllezër të një gjaku etnik, janë aq grindavecë e mos bashkëpunues mes veti, e në ndërkohë, të kujdesshëm dhe të mirësjellshëm ndaj kolegëve të tyre të huaj?! Shpjegimi është shumë i thjeshtë: ata janë vëllezër për nga përkatësia etnike, por kuletat e tyre që i mbushin me hajni, nuk janë motra!

- Më lehtë e ke gjithë qentë t'i mësosh të urinojnë te e njëjta pemë, se sa politikanët shqiptarë t'i ulësh bashkërisht rreth të njëjtës tavolinë të bisedimeve!

- E di se demokraci është edhe kur dy kokëzbrazur, kriminelë dhe të pafytyrë, e mbivotojnë një të ditur e të ndershëm, por kjo ende nuk do të thotë se injoranca, krimi dhe pafytyrësia, janë vlera civilizuese e njerëzore!

- Dikur shqiptaria mbështetej mbi parimin e fisëm dhe bujarë se turpin e burrit nuk e mban toka, e atë të gruas nuk e mbulon as dheu! Sot, thuajse shumëçka ka marr kahe të kundërt dhe herë-herë, kam përshtypjen se kemi filluar t'i nënshtrohemi rregullit se, paturpësia e burrit mund ta sundojë tokën, e ajo e gruas mund ta zbukurojë dheun!

- Është e vështirë ta përcaktosh saktë se sa të peshojnë të tjerët!

***Letra i drejtohet gazetares dhe kritikes së librit Alda Bardhyli***

Opinioni i Ditës

# Donika Prela, një arsye më shumë pse duhen djegur mandatet

Nga Andi Bushati



*(vijon nga faqja 1)*

... e Krimeve të Rënda, Donika Prela, pasi ka kaluar sitën e bërë shoshë të vetingut, e renditi emrin e saj mes kandidatëve të SPAK-ut, pra prokurorisë speciale që do të bëjë "namin" me shpënien prapa hekurave të politikanëve të lartë.

Po pse, ky detaj, qenkësh kaq i rëndësishëm në sfondin e këtyre përplasjeve të mëdha? Çfarë lidhje kanë mandatet e opozitës me emrin e përveçëm të një prokuroreje?

Përgjigjja është e thjeshtë. Ky emër dhe ky kazus është simboli më tipik i krimit më të madh që po ndodh në Shqipëri. Ai përmbledh, njëkohësisht, kapjen totale të shtetit nga Rilindja, përpjekjen për të fshehur (por njëkohësisht edhe për të ruajtur) lidhjet e ardhshme me krimin dhe mbi të gjitha, ai gropos njëherë e mirë ëndrrën iluzore të shqiptarëve që pasi kanë humbur besimin te kjo klasë politike, shpresojnë se pas vetingut të dirigjuar nga ndërkombëtarët, të gjithë do të shohim një ditë të bardhë.

Le t'i marrim ngjarjet me radhë dhe të përpiqemi të shpjegojmë në mënyrë sa më thjeshtëzuar atë që ka ndodhur.

Fryti i parë i drejtësisë së re ishte vënia e një kryeprokuroreje të parashutuar nga hiçi, merita e së cilës ishte se kishte punuar nën Hulsi Manjën. Arta Marku u zgjodh në mënyrë antikushtetuese vetëm me 69 vota të socialistëve. Të gjithë atyre që thërritën skandal, si nga opozita, si nga kritikët e reformës, iu ofrua pilula qetësuese. Ajo do të qëndrojë vetëm dy - tre muaj, ajo nuk do të ketë kompetencë t'u heqë vartësve të saj nga duart dosjet sensitive, si ajo e Saimir Tahirit dhe mbi të gjitha, ajo nuk do të ketë mundësi të bëjë lëvizje brenda prokurorisë.

Sot, një vit e gjysmë më pas, të gjitha këto kanë rezultuar gënjeshtra. Por në këtë histori ne na intereson vetëm kriteri i fundit. Arta e partisë e shkeli edhe atë. Një nga veprimet e saj të para ishte komandimi në krye të prokurorisë i një mikeshës së saj, pikërisht Donika Prelës, te Rrimet e Rënda. Dikush mund të mbrohet duke thënë se ishte rastësi, por rastësia zgjodhi pikërisht të gradojë në detyrë, ish-drejtuesen e Prokurorisë të Durrësit, që i ishin vjedhur dy herë me radhë dosjet sensitive dhe ku ishte kryer mëkati i bashkëpunimit të Vangjush Dakos me Avdylajt në blerjen e zgjedhjeve.

Përsëri ndoshta është përkim fatkeq, por pjesa politike e asaj që tani njihet si dosja '339', bashkë me përgjimet që kishte brenda, u arkivua po nga Prela, për t'u hetuar nuk dihet se kur.

Edhe deri këtu dikush mund të thotë që ishte e kuptueshme. Në lojë ishin prokurorët e kohës së vjetër, që nuk kishin kaluar në filtrat euroatlantikë të vetingut, që u thurën me aq mundim nga Lu dhe Vlahutin. Kur ato të funksiononin gjithçka do të ishte rozë.

Por, kontrolli për prokurorët filloi dhe Arta Marku, megjithëse u fshikullua ashpër për emërimet dhe lëvizjet e saj aspak transparente, doli e pastër prej tij.

Radha i erdhi edhe njëres prej këtyre të lëvizurave, Donika Prelës. Këtu historia nga tragjike, fillon dhe bëhet komike. Pikërisht ajo, shefja e Krimeve të Rënda, nuk justifikon dot pasurinë, del se dy apartamente dhe një tokë në Pe-trelë i ka blerë (nuk dihet kujt njeriu të ndershëm i lindi në zemër) nën çmimet e tregut, se bashkëshorti i saj ka fshehur pagën e për rrjedhojë, edhe taksat.

Përfaqësuesi i OMN-së, belgu Teo Jacobs i shikon me sytë e tij këto gjëma që kanë djegur dhjetëra të singjashëm më parë. Ai vë alarmin publikisht se ka mbetur me një shije të hidhur në gojë dhe se ky lloj modeli nuk bën pjesë në kodin e tij.

Por, asgjë më shumë. Shfaqja teatrale e vetingut shtyhet edhe me një seancë plus, derisa trupa e përbërë prej Roland Ilia, Olsi Komici dhe Valbona Sanxhaktari e shpallin Donika Prelën po aq të virgjër sa ç'e ka bërë nëna. Belgut të shushatur Jacobs, i cili në sytë e shqiptarëve simbolizon garantin ndërkombëtar që nuk do lejojë që reforma në drejtësi të shndërrohet në batërdi, nuk i mbetet veçse t'i shtrëngojë dorën para kamerave Prelës.

Pa kaluar as dy javë nga ky episod, ajo njofton se do të konkurrojë për pjesëtare të SPAK, zyrës speciale që do kryqëzojë politikanët e korruptuar dhe të kriminalizuar.

Kjo është kronologjia e fakteve nga e cila nuk është e vështirë të arrihet në përfundime.

Ajo, me anë të çiftit Arta Marku, Donika Prela tregon se pse u zgjodh një vit e gjysmë më parë mes tymit, flakëve dhe çizmeve, Prokurorja e Përgjithshme e njëanshme.

Ajo tregon se, ndryshe nga sa thuhet, kush ka më shumë frikë nga krimet që ka kryer dhe po mundohet të kapë drejtësinë për t'i varrosur ato.

Ajo tregon se si po përdhoset vetingu dhe se si po trajtohen si lolo oborri, përfaqësuesit e OMN-së, që nuk duhet të toleronin degjenerimin e tij.

Ajo tregon se ç'plane po thuren për nesër, kur njerëzit që kanë dhënë garanci në skutat më të errëta të lidhjeve të politikës me krimin, po katapultohen përmes SPAK-ut në drejtësinë e së ardhmes.

Në këtë kuptim, sado i trishtë që të duket, përkimi i kandidimit të Donika Prelës në të njëjtën kohë me momentin e djegies së mandateve është një rast për reflektim. Një shembull simbol se kush i thotë vërtet vetes kundërshtar i kësaj skote mafioze, nuk mund të qëndrojë më në atë Kuvend. Një argument shterues se pse opozita duket qesharake në atë sallë, ku Arta Marku u zgjodh në mënyrë antikushtetuese dhe ku reforma e votuar me 140 vota po përdoret si mburojë për krimin.

Ky akt radikal është një rrugëdalje shpëtimi edhe për ata diplomatë lokalë, që sot po e anatemojnë me forcë atë. Sepse kjo është shpresa e fundit për të ndaluar vdekjen që pa lindur të një reforme, për të cilën ata u investuan aq shumë. Pak më vonë do të jetë vërtet vonë. Dhe ata vetë do t'i përqeshin në Tiranë, po njësoj si Kadafi, Asadi, apo Ben Aliu bënë me perëndimorët që i mbështetën dikur me shpresën se do t'i bënin më të mirë.

> Fryti i parë i drejtësisë së re ishte vënia e një kryeprokuroreje të parashutuar nga hiçi, merita e së cilës ishte se kishte punuar nën Hulsi Manjën. Arta Marku u zgjodh në mënyrë antikushtetuese vetëm me 69 vota të socialistëve. Të gjithë atyre që thërritën skandal, si nga opozita, si nga kritikët e reformës, iu ofrua pilula qetësuese.

Opinioni i Ditës

# Edi Ramës duhet me ligj t'i ndalohet të merret me politikë!

Nga Kim Mehmeti

*(vijon nga faqja 1)*



... të tillë, çdokund rreth vetes, ata shohin individë me të meta fizike e mendore, e me të cilët mund të tallen sa të duan, e kur të duan! Pra, si të tillë ata, çdokund shohin kazanë ku kalben kundërshtarët e tyre politikë, si dhe tepsi me bakllava, që u takon vetëm atyre. Politikanët e tillë bëjnë çmos që paturpësinë dhe krimin ta ngrenë në vlerë politike, me çka debatin politik e zbresin në nivel të zënkave nëpër plazhet nudistike dhe nëpër bordele! Dhe ndodh që politikanët e tillë të jenë zbavitës dhe ekzotikë për perëndimorët, por fatkeqësi e madhe e popullit dhe vendit që drejtojnë, ngaqë kanë tipare të kundërta nga ata të qeni besnik: u lëpihen të huajve dhe e lehin dhe e kafshojnë të vetin!

Shqiptarisë nuk i mungojnë as burrështetas të llojit të Presidentit të sotëm të Kosovës, i cili shtetin e sheh si pronë të veten private! Dhe duke e konsideruar vendin si pasuri të veten, ata besojnë se edhe kufijtë e tij ndërrohen si ato të livadheve që i ke trashëguar nga të parët e tu! Dhe ndërtojnë shtet të pabanueshëm për popullin, por parajsë për të afërmit e tyre!

Nëpër 'Shqipëritë' tona ka shumë politikanë, të ngjashëm me drejtuesit e BDI-së, të cilët besojnë se posa e vë kravatën e politikanit, nga injorant bëhesh më i mençuri i botës! Dhe politikanët e tillë jo vetëm që e marrin në qafë popullin, por duan ta arrijnë të pamundurën: t'u takojë edhe lavdia, edhe hajnia!

Thënë shkurt e shqip: 'Shqipëritë' tona kanë përplot politikanë që janë fati i fqinjëve tanë dhe i të huajve, por fatkeqësia jonë! Andaj duhet që një ditë e më parë, atyre me ligj t'u ndalohet të merren me politikë! Dhe kjo duhet bërë edhe kur kjo nuk u pëlqen miqve tanë perëndimorë, të cilët kanë filluar të besojnë se shqiptaria është një kopsht i mbrojtur nga mjeranë të paaftë, ta njohin dhe ta murojnë mirëqenien e vet"!




## HOROSKOPI

### DASHI
Financat nuk do të jenë të përkryera kështu që shmangni marrjen e vendimeve të mëdha. Investimet lërini për më vonë. Për të parandaluar zënkat me koleget në punë më mirë mos jepni shumë detaje. Në përgjithësi gjërat do ecin qetësisht në dashuri.

### DEMI
Për çdo hap duhet të tregoheni sa me të kujdesshëm. Gjendja e financave do vazhdojë të mbetet po ashtu si ka qenë. Në punë ka shumë mundësi që mungesa e komunikimit dhe e diplomacisë t'iu sjellë disa vështirësi.

### BINJAKET
Financat do jenë shumë herë më të kënaqshme kështu që përfitoni për të bërë disa investime të nevojshme. Në punë kjo do të jetë ditë vendimtare. Do dini të ecni me plane dhe nuk do t'ju ndodhin aspak probleme.

### GAFORJA
Në planin financiar do i keni të gjitha aftësitë për ta mbajtur situatën nën kontroll, por ndonjëherë do e lëshoni dorën dhe do shpenzoni më shumë. Për punën do jetë ditë disi më e mirë, sepse do keni ndonjë rritje në detyrë.

### LUANI
Duhet të tregoni sa vleni realisht në profesionin tuaj, duke nxjerrë në pah idetë që keni. Në raportin në çift nuk parashikohen zhvillime të reja. Me financat, gjërat do shkojnë shumë mirë.

### VIRGJERESHA
Sektori i financave do ketë disa ndryshime pozitive, megjithatë kjo nuk do të thotë të shpenzoni shumë. Nëse merrni një ofertë të re mos ngurroni të pranoni, sepse mund të jetë shumë premtuese.

### PESHORJA
Në aspektin ekonomik do jeni me fat dhe gjendja nuk do përkeqësohet pavarësisht mungesës së kujdesit nga ana juaj. Në punë nuk ka për të ndryshuar situata. Ju mungon dëshira për ndryshime.

### AKREPI
Në punë do jeni shumë më të suksesshëm se më parë. Do merrni jo vetëm përgëzime dhe shpërblime, por edhe propozime për ngritje ne detyre. Stresi mund t'ju krijojë herë pas here probleme

### SHIGJETARI
Në punë duhet të jeni më të përqendruar dhe më objektivë. Vetëm në këtë mënyrë do arrini gjithçka qe keni dashur. Me financat mund të keni lajme të reja. Në dashuri mund të kaloni disa pengesa.

### BRICJAPI
Ata që janë në një lidhje do ndihen paksa konfuze sot. Me financat do merreni më shumë se më parë dhe do mundoheni që ta ndryshoni situatën. Në punë do filloni disa projekte të reja të cilat mund t'ju sjellin përfitime.

### UJORI
Beqaret mund të jenë me fat. Ata mund të gjejnë princin e kaltër. Gjendja financiare do vazhdojë të mbetet e mirë sidomos nëse dini të tregoheni të matur me shpenzimet. Një investim i kaluar mund të sjellë rezultate.

### PESHQIT
Sektori financiar nuk do të ketë rreziqe, sepse jeni i kujdesshëm me paratë. Ju qe jeni në një lidhje mundet të mos përjetoni ndjesitë e shumëpritura ose mund të mos merrni reagimin që do të donit nga një person për të cilin keni simpati.

TRAJNERI I TIRANËS

## Mema: Marrim pikë në Korçë, pastaj mendojmë për derbin

Tirana është e impenjuar sot në transfertën e Korçës, ku do të ndeshen me Skënderbeun vendës. Trajneri i bardhebluve, Ardian Mema, kërkon që të mos kthehet duarbosh nga kjo sfidë, ndërsa më pas i gjithë fokusi i tij është derbi ndaj Partizanit. "Luajmë një ndeshje shumë e vështirë me Skënderbeun. Të gjitha ekipet janë në vështirësi. Do bëjmë maksimumin për të marrë rezultat pozitiv në Korçë. Tiranës i bën mirë të mos humbasë. Shkojmë për të fituar, por si çdo ndeshje, të tria rezultatet janë brenda. Skënderbeun kam gjithë javën që e analizoj, kanë specifikat e tyre. E kemi përgatitur ndeshjen dhe ekipi ka treguar se është i karikuar. Statistikat nuk i di. Në 10 vitet e fundit ata kanë qenë ekipi më i fortë. Tani u ka humbur disi shkëlqimi, pasi shumë lojtarë kanë ikur. Por, unë jam trajneri i Tiranës dhe dua të fitoj. Derbin nuk e mendojmë. E kemi thënë këtë edhe me lojtarët. Ndeshjet i marr një nga një. Kjo do na bënte mirë për pikët. Tirana i ka shumë të nevojshme. Për derbin do mendojmë pas kësaj jave".

TRAJNERI I SKËNDERBEUT

## Orges Shehi fal Oto Xhon: Do na e shpërblejë me gola

Skënderbeu pret sot Tiranën dhe pas humbjes në Vlorë, do të të kërkojë të rikthehet te fitorja, pasi në 8 sfidat e fundit bardhekuqtë kanë 1 fitore dhe 7 humbje. Kundër Tiranës do të jetë e vështirë, por Orges Shehi, trajneri i Skënderbeut, shpreson që të arrijë suksesin falë dhe golave të Oto Xhon, sulmuesi që i mohoi skuadrës korçarëve mbase barazimin në Vlorë me atë ndërhyrje të kotë në gjuajtjen e Krasniqit. "Është detyrim të fitojmë. Kemi përballë Tiranën dhe fitorja na duhet për t'u kthyer aty ku duhet. E bëmë ndaj Laçit, por pësuam një disfatë në Vlorë. Tani është koha të rikthehemi përsëri. Do të jetë mjaft e vështirë, pasi Tirana ka pasur vazhdimësi, ndryshe nga ne. Kemi bërë futboll, por bëjmë gabime individuale, që po na humbasin dhe pikë. Lojtarët nuk i kemi në formën optimale. Nuk janë në 100%. Kundër Tiranës, do të kushtëzohemi sërish nga dëmtimet. Oto Xhon? Është gjëja më e thjeshtë ta kryqëzosh. Por, është lojtari ynë dhe i japim përsëri shans, e shpresojmë të na e shpërblejë".

Keidi Bare është shndërruar një nga elementet fiks të formacionit të Malagës në ligën e dytë

# Bare: Nga familja u largova me lot në sy

### *Mesfushori kuqezi rrëfen aventurën e tij spanjolle*



Jeton Selimi

Zënia e një vendi titullari menjëherë te Malaga nga ana e Keidi Bares i ka habitur të gjithë për mirë, tek klubi spanjoll që lufton të ngjitet në La Liga. Në një artikull nga "ElDesmarque.com" për fierakun, ai shpjegon rrugëtimin e vështirë në 11 vite për të arritur deri në këto nivele të larta. "Që në një moshë të vogël, e kisha të qartë në mendje se doja të shkoja në nivele të larta të futbollit. Ende shpresoj që kjo të ndodhë. Mendoj se po i bëj gjërat mirë dhe dua të vazhdojë kështu. Shqipëria është një vend i vogël dhe shumë pak lojtarë luajnë jashtë shtetit. Nga atje jam larguar 11 vjeç. Shkova në Greqi për katër vite dhe familja qëndroi në Shqipëri. Më pas u riktheva sërish në vendin tim, për të ardhur më pas në Spanjë. Ku kanë kaluar 6 vite. Në shtëpi që i vogël më kanë ngulitur në mendje se për të pasur një jetë të mirë, do duhej të luaja jashtë. Kjo më ka bërë mirë dhe më ka bërë më të pjekur, por ka vështirësitë e veta, sepse je gjithmonë larg shtëpisë dhe familjes. Mbaj mend kur u largova nga shtëpia me lot në sy, por kështu e ka jeta. Futbolli është sakrificë", - shprehet fillimisht Bare. Më pas ai tregon si erdhi në Madrid te Atletiko, dhe vendimin për të kaluar te Malaga. "Që i vogël kam luajtur në rrugë. Aty më pa një trajner dhe i tha babait tim që të më çonte tek ai. Më pas, shkova në Greqi tek Panathinaikosi, por nuk mund të luaja prej dokumentacionit. Nuk e dija se do shkoja tek Atletiko, por më thirrën për një testim dhe më në fund shkova atje. Takova idhullin tim, Fernando Torres. Ishte sikur isha zgjuar nga një ëndërr. Më trajtuan shumë mirë atje. Këtë verë vendosa të vij këtu. Nga Atletiko nuk më thanë që të ikja, kisha edhe një vit kontratë, por unë nuk kënaqem vetëm me diçka, me të qenurit në një ekip dhe kaq. Tani jam në skuadrën e parë falë trajnerin dhe duam të shkojmë shumë larg. Është edhe ëndrra ime, e do arrij me shokët e skuadrës dhe trajnerin. Më kanë mësuar gjithmonë me këtë frymë. Babain e kam gjithmonë mbrapa duke më thënë se duhet të punoj akoma më fort, për të shkuar më larg", - tregon Bare.




LIGA E EUROPËS

## Napoli kualifikohet me lehtësi, ja nota për Hysajn

Mbrojtësi i Kombëtares kuqezi ka qenë nga minuta e parë sot në përballjen që Napoli zhvilloi me helvetët e Zyrihut në "San Paolo". Skuadra e Ançelotit fitoi ndeshjen e parë me rezultatin 3-1, duke e mbyllur praktikisht çështjen e kualifikimit që në Zvicër. Në takimin e mbyllur pak çaste më parë, të kaltrit kanë triumfuar 2-0 me golat e Simone Verdit në të 43'-ën dhe të Adam Ounas në të 75'-ën. Hysaj nuk ka pasur shumë punë në mbrojtje, ndërsa e gjithë prapavija napolitane është vlerësuar me të njëjtën notë, 6.5, përveç Hysajt që ka merituar gjysmë note më pak, 6. "I fortë dhe i kujdesshëm pas shpatullave të Ounas, duke mbyllur dhe ato hapësira që u krijuan në rastet e pakta me të cilat Zyrihu kërkoi të bëhej i rrezikshëm", lexohet në vlerësimin për shkodranin e Napolit.

SULMUESI NË KRIZË

## Zi e më zi për Mauro Ikardin! Edhe Argjentina i bën dalje

Polemikat e fundit në shtëpinë e Interit kanë ndikuar dhe në të ardhmen e Mauro Ikardit me fanellën e Argjentinës. Sipas asaj që shkruan "Tuttosport", pas vuajtjeve të shumta për të eliminuar paragjykimet, Ikardi do të kthehet të veshë fanellën e "la Seleçion" pas ndeshjeve të marsit. Trajneri Skaloni për dy sfidat e radhës kundër Venezuelës dhe Marokut, në program më 22 dhe 26 mars, ka bërë ndërmend të mos e thërrasë Mauron, që së fundmi nuk është stërvitur me grupin, pasi është ankuar për dhimbje në gju. Por pas kontrolleve mjekësore, rezultoi se Ikardi nuk ka asnjë shqetësim, çka e ka vendosur lojtarin në një pozitë konflikti me Interin, pasi argjentinasi ka shmangur stërvitjen me ekipin pas heqjes së shiritit të kapitenit.



Ters për brazilianin e Kukësit

## Ulliam Kordeiro thyen dorën, 6 javë larg fushave

Periudhë aspak e mirë për Ullian Kordeiron, anësorin brazilian të Kukësit, që pas penalltisë së humbur ndaj Teutës, po kalon një telash fizik. Ulliam Kordeiro ka pësuar një frakturë në dorën e djathtë dhe i është dashur të ndërhyjë në të. Koha e rikuperimit? Katër deri në gjashtë javë. Ai ka njoftuar në "Facebook" për situatën e tij: "Për fat të keq, unë nuk do të luaj për 4-6 javë për shkak të një frakture në dorë. Luajta 3 ndeshjet e fundit me dorën e dëmtuar dhe gjërat u përkeqësuan. Më vjen shumë keq për këtë, por këto ndodhin në futboll. Do të përqendrohem te periudha e rikuperimit dhe do të kthehem më i fortë".




GAZETA SHQIPTARE
RUSSIA 2018
LAJME
KALENDARI
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
VIP
BLUE TOOTH
Brikena Duva:
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al